



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 44, datë 10.06.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT “**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 9 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë, të neneve 7, 11, 24 dhe 26 pika 2 të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të nenit 27 të ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe të nenit 12, shkronja “a” dhe 43, gërma “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”

V e n d o s i:

1. Të miratojë rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për parandalimin e pastrimit të parave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.10, datë 25.02.2004.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**RREGULLORE
“PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT “**

(Miratuar me vendimin nr.44, datë 10.06.2009 dhe ndryshuar me vendimin nr. 55, datë 28.08.2013, me vendimin nr. 22, datë 5.4.2017 dhe me vendimin nr. 78, datë 18.12.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

**Kreu I
Të përgjithshme**

**Neni 1
Objkti**

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, i rregullave për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës nga subjektet e kësaj rregulloreje, ¹për qëllime të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**Neni 2
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim parandalimin e përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

**Neni 3
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet e ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të cilat licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë.

**Neni 4
Baza juridike**

²Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 9 dhe nenit 126, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 60, pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr.52/2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; dhe të ligjit nr.157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.

¹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

² Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

Neni 5 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar³, në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ⁴në ligjin nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar⁵, si dhe në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁶.

2. Termi “Ligji për parandalimin e pastrimit të parave” do të nënkuptojë ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar ⁷dhe termi “Ligji për masat kundër financimit të terrorizmit” do të nënkuptojë ligjin nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”⁸, i ndryshuar⁹.

Kreu II Vigjilenca e thjeshtuar, vigjilenca e duhur dhe vigjilenca e zgjeruar¹⁰

Neni 6 Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet¹¹

1. Subjektet marrin masat e “vigjilencës së thjeshtuar”¹², “vigjilencës së duhur” dhe “vigjilencës së zgjeruar” në rastet e përcaktuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe zbatojnë masat e identifikimit dhe verifikimit të klientëve ¹³të përhershëm apo rastësorë (persona fizikë, juridikë apo organizime ligjore), sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj dhe në dispozitat e kësaj rregulloreje.¹⁴
2. Subjektet hartojnë politika, udhëzime apo procedura të brendshme për pranimin, identifikimin, regjistrimin, monitorimin, administrimin e rrezikut si dhe raportimin e transaksioneve të klientëve, siç përcaktohet në nenin 2, pika 21, si dhe në nenin 11 dhe 12¹⁵ të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.¹⁶

³ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁴ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

⁵ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁶ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁷ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁸ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

⁹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

¹⁰ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

¹¹ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

¹² Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

¹³ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

¹⁴ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

¹⁵ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

¹⁶ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

3. ¹⁷Subjektet hartojnë rregullat dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit, të cilat parashikojnë në veçanti hapat që duhet të ndjekin, rolin e strukturave të subjekteve në këtë proces, si dhe autoritetin ku duhet të raportojnë, me qëllim sigurimin e parandalimit të lëvizjes dhe përdorimit të fondeve të personave dhe subjekteve të përfshirë në financimin e terrorizmit apo prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë, në përputhje me listat e personave të shpallur dhe sanksioneve përkatëse të përcaktuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara¹⁸.
4. Subjektet identifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë klientët e tyre dhe pronarët përfitues, si dhe kërkojnë informacione shtesë në rastet kur e gjejnë të arsyeshme.
5. Subjektet bëjnë verifikimin e identitetit të klientit nëpërmjet dokumenteve ligjërish të vlefshme. Dokumentet që paraqiten nga klienti pranë subjektit duhet të jenë origjinale ¹⁹ose fotokopje të noterizuara ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik. ²⁰Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose kryerjes së transaksionit/eve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit në formën e mësipërme, të cilat duhet të jenë të vullosura me vulën e subjekteve të kësaj rregulloreje, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.
6. ²¹Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre, para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.
²²Subjektet miratojnë dhe zbatojnë procedura specifike të administrimit të rrezikut, në rastet e transaksioneve apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.
7. ²³Në rastin e përfaqësimit të klientit nga një person i tretë nëpërmjet një akti përfaqësimi, subjektet verifikojnë nëse ky person është i autorizuar për të përfaqësuar klientin dhe për të kryer veprimet e kërkuara, kërkojnë të dhëna për identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij dhe i verifikojnë këto të dhëna, si dhe mbajnë në dosjen e klientit të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej personit të tretë, duke përfshirë dhe origjinalin ose kopjen e noterizuar të aktit të përfaqësimit.
8. ²⁴Subjektet, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi dhe/ose të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të klientëve (të rinj dhe ekzistues), konsultojnë listën e përditësuar të personave të shpallur si financues të

¹⁷ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

¹⁸ UNSCR - United Nations Security Council Resolution.

¹⁹ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

²⁰ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

²¹ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

²² Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

²³ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

²⁴ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

terrorizmit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe njoftojnë Bankën e Shqipërisë, sipas ligjit për masat kundër financimit të terrorizmit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

9. Subjektet refuzojnë hapjen e llogarisë së klientit, kryerjen e transaksioneve dhe nuk hyjnë në marrëdhënie biznesi me të, në rast se nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e tij dhe kërkesat e vigjilencës së duhur të parashikuara në kreun II²⁵ të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave²⁶.
10. Në rast se subjektet në çdo kohë dyshojnë për identitetin e klientit, ato pezullojnë menjëherë çdo veprim me të si dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës, në përputhje me kërkesat për raportim të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.
11. Në rastin e klientëve që kanë marrëdhënie biznesi me bankat dhe degët e bankave të huaja, transaksionet për llogari të tyre kryhen në çdo rast nëpërmjet llogarisë së vetë klientit/ëve.
12. ²⁷Subjektet kryejnë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, nëpërmjet mbledhjes së informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e kësaj marrëdhënieje dhe krijimit të profilit të rrezikut të tij, si dhe analizën e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e veprimitarisë që kryen, profilin e rrezikut dhe burimin e fondeve.
13. ²⁸Subjektet përcaktojnë në procedurat e tyre të brendshme, frekuencën e monitorimit të vazhdueshëm në përputhje me profilin e rrezikut të klientëve.
14. ²⁹Subjektet kryejnë vlerësimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bazuar në vlerësimin kombëtar të rrezikut të vendit, në kategorinë e klientëve dhe të transaksioneve të kryera, në strategjitë e vetë subjekteve dhe rreziqet e ndërmarra prej tyre si dhe në zhvillimet e produkteve të reja dhe përdorimin e teknologjive të reja.
15. ³⁰Subjektet, që janë pjesë e grupeve bankare dhe/ose financiare, zbatojnë programet e grupit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për sa janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.
16. ³¹Subjektet, në rastin kur mbështeten në palë të treta, zbatojnë kërkesat e parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave.

²⁵ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

²⁶ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

²⁷ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

²⁸ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

²⁹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

³⁰ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

³¹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

Neni 7

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

Subjektet regjistrojnë në bazën e tyre të të dhënave çdo informacion që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer në emër ose për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni, së bashku me dokumentacionin mbështetës, kryhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në nenin 16, të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 8

Strukturat përgjegjëse të subjekteve

1. Subjektet krijojnë strukturën/at dhe infrastrukturën e nevojshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. ³²Subjektet caktojnë një person përgjegjës, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.
3. Strukturat përkatëse të subjektit vënë në dispozicion të personit përgjegjës, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, mjetet dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e funksionit të tij (si për shembull teknikën e përshtatshme, personelin e mjaftueshëm, një buxhet të arsyeshëm etj.).
4. Subjektet njoftojnë Bankën e Shqipërisë për emrin e personit përgjegjës të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në të gjitha rastet që ka ndryshime të këtij personi.
5. ³³Subjektet i vënë në dispozicion Bankës së Shqipërisë, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, të parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje
6. ³⁴Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore/procedura për vlerësimin dhe kategorizimin e klientëve apo transaksioneve sipas shkallës së rrezikut që ato paraqesin, në përputhje me ³⁵ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Përveç kategorive të parashikuara në ³⁶ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, subjektet mund të përcaktojnë edhe kategori të tjera rreziku duke iu referuar udhëzuesit “Për vlerësimin e rrezikut mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit” bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

³² Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

³³ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

³⁴ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

³⁵ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

³⁶ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

7. Degët dhe agjencitë e subjekteve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë regjistrojnë të gjitha veprimet bankare dhe financiare të çdo klienti për shumat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja. Drejtoria e përgjithshme e subjektit ruan dhe mban të gjitha raportimet e bëra nga degët dhe agjencitë e subjektit, si dhe të dhëna të përmbledhura për të gjithë rrjetin e saj në Shqipëri.
8. ³⁷Subjektet sigurohen se filialet, degët, si dhe agjencitë e tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti në vendet, dhe territoret, të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Në qoftë se masat parandaluese në vendet ku janë këto filiale, degë, si dhe agjencitë e tyre ndryshojnë, atëherë subjektet duhet të sigurohen që kanë përparësi detyrimet më të larta. Nëse ligjet e vendit, ku janë vendosur filialet, degët, ose agjencitë, parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve ³⁸dhe të masave parandaluese, subjekti duhet të raportojë për këto pengesa tek autoriteti përgjegjës dhe sipas rastit dhe në Bankën e Shqipërisë.
9. ³⁹Subjektet parashikojnë në procedurat e brendshme të punësimit, edhe kritere mbi pastërtinë e figurës dhe integritetin ⁴⁰e punonjësve, veçanërisht të atyre të përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me qëllim parandalimin e rrezikut të përfshirjes së tyre në veprimtari kriminale, të pastrimit të parave, mashtrimit, etj.
- 9/1. ⁴¹Subjektet hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trainimit të personit përgjegjës dhe të punonjësve të strukturës përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
10. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trainimit të punonjësve të subjekteve, lidhur me rregulloret dhe procedurat e brendshme të miratuara për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
11. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, informojnë periodikisht punonjësit e këtyre të fundit lidhur me ndryshimin e dispozitave ligjore në fuqi për parandalimin dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për detyrimet e tyre lidhur me zbatimin e këtyre ndryshimeve.
12. ⁴²Shfuqizuar.
13. ⁴³Shfuqizuar.

³⁷ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

³⁸ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

³⁹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

⁴⁰ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁴¹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁴² Shfuqizuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

14. Punonjësit e subjekteve ruajnë konfidencialitetin për procesin e raportimit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimeve dhe për raportimin e bërë tek autoriteti përgjegjës.

Neni 9

Raportimi tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës sipas formularëve të raportimit dhe afateve të përcaktuara me akt nënligjor nga autoriteti përgjegjës për:
 - a. gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve⁴⁴;
 - b. shfuqizuar⁴⁵.
2. Subjektet, kur kanë arsye të besojnë ose të dyshojnë se transaksioni i kërkuar për t'u kryer nga një klient apo një person tjetër për llogari të klientit, mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale⁴⁶, ia raportojnë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës. Në këto raste, subjektet presin deri në 48 (dyzetë e tetë) orë pas raportimit në autoritetin përgjegjës për udhëzimet e këtij të fundit, nëse duhet ta kryejnë apo jo transaksionin.
3. ⁴⁷Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transfertat parash ose vlerash, në rastin e transfertave në niseje dhe në mbërritje, kërkojnë informacion lidhur me urdhëruesin dhe përfituesin, i cili minimalisht përfshin, emrin, mbiemrin, adresën, ⁴⁸numrin e dokumentit të identifikimit/numrin personal, ose IBAN-in (në rastet kur është i aplikueshëm), ose numrin e llogarisë, si dhe emrin e institucionit financiar të përfshirë në transfertë. ⁴⁹Në rast se nuk ka një numër llogarie, transfertat shoqërohet nga një numër unik reference. Në rast se ky informacion nuk paraqitet i plotë, subjektet refuzojnë kryerjen e transaksionit dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës. Informacioni i plotë identifikues shoqëron transfertën në fazat e lëvizjes së saj nga dërguesi i parë tek përfituesi i fundit.
4. ⁵⁰Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transfertat parash ose vlerash, duhet të mbajnë një listë të agjentëve që operojnë për llogari të tyre. Këta agjentë do të konsiderohen si pjesë e subjektit, i cili duhet t'i trajtojë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të sigurohet që ata zbatojnë të njëjtat masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit.

⁴³ Shfuqizuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

⁴⁴ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁴⁵ Shfuqizuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁴⁶ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁴⁷ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

⁴⁸ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁴⁹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁵⁰ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

5. ⁵¹Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Kreu III Dispozita të fundit

Neni 10 Kërkesa mbikëqyrëse

1. Banka e Shqipërisë, mbikëqyr zbatimin e dispozitave të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Banka e Shqipërisë raporton tek autoriteti përgjegjës çdo dyshim, çdo informacion ose të dhënë që vlerëson se mund të lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, të cilat i konstaton gjatë procesit të mbikëqyrjes ⁵² subjekteve të kësaj rregulloreje.
3. Banka e Shqipërisë vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
4. Banka e Shqipërisë, për të gjitha shkeljet e evidentuara të cilat mund të klasifikohen si kundravajtje administrative, në bazë të nenit 27 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, informon autoritetin përgjegjës duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë që ka lidhje me konstatimin e shkeljes.
5. ⁵³Shfuqizuar.
6. ⁵⁴Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

⁵⁵Neni 11 Kërkesa raportuese

⁵¹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁵² Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁵³ Shfuqizuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁵⁴ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁵⁵ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

Subjektet raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë mbi baza vjetore, të dhënat e kërkuara sipas Aneksëve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, brenda 30 ditëve pas mbylljes së vitit kalendarik.

⁵⁶Neni 12
Dispozitë kalimtare

⁵⁷Neni 13
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë merr masa mbikëqyrëse dhe ndëshkimore ndaj subjekteve të kësaj rregulloreje, siç përcaktohet në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe ligjin nr.52/2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre, të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtyre subjekteve, nëse konstaton se këto subjekte nuk zbatojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Banka e Shqipërisë, kur e gjykon të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa veprimtari, apo të revokojë licencën e subjektit, në rastet kur kërkohet nga autoriteti përgjegjës, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

⁵⁶ Shfuqizuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

⁵⁷ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

UDHËZUES

PËR MATJEN E RREZIKUT NGA PASTRIMI I PARAVE DHE FINANCIMI I
TERRORIZMIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë subjektet e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (në vijim referuar si PPP/LFT), në administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Udhëzuesi nuk zëvendëson detyrimet ligjore të subjekteve, por synon t'i ndihmojë ato për të kuptuar dhe administruar rreziqet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet këtij udhëzuesi, ofron një qasje të bazuar në rrezik në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare për administrimin efektiv të rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë inkurajon subjektet që të zhvillojnë praktika apo procedura për të vlerësuar dhe parandaluar kryerjen e veprimeve të cilat përdoren për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit. Për këtë qëllim, udhëzuesi dhe matrica në aneksin bashkëlidhur, do të shërbejnë si një mjet ndihmës në procesin e vlerësimit të rreziqeve që vijnë nga aktiviteti në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

I. Përshkrim i përgjithshëm mbi matjen e rrezikut

Subjektet, së pari, identifikojnë rreziqet e mundshme të pastrimit të parave, me qëllim zbatimin e një sistemi efikas të matjes së rrezikut. Këto rreziqe mund të identifikohen në forma nga më të ndryshmet, por kryesisht ato identifikohen në bazë të faktorëve të rrezikut.

Me faktorë rreziku do të kuptojmë bashkësinë/grupin e kategorive të klientëve, produkteve dhe shërbimeve/transaksioneve, marrëdhënieve të biznesit, si dhe zonës gjeografike të përcaktuar nga burime të besueshme informacioni si grup kategorish gjerësisht të pranuar për të vlerësuar rrezikun.

Me burime të besueshme informacioni në këtë udhëzues, i referohemi informacionit publik, të vënë gjerësisht në dispozicion nga organe të njohura dhe me reputacion, si për shembull Organizata e Kombeve të Bashkuara, FATF, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Këshilli i Evropës, OFAC, Grupi Egmont etj.

Drejtesit e lartë të subjektit financiar duhet të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut dhe proceset për zbutjen e tij të kryhen në mënyrë profesionale, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe parandalimin e çdo veprimi të paligjshëm, i cili synon pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Identifikimi i nivelit të rreziqeve të mundshme ndihmon subjektet për të marrë masat e duhura për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Identifikimi i rreziqeve fillon që në momentin e parë që klienti kërkon të hyjë në marrëdhënie biznesi

⁵⁸ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

me subjektin. Në vazhdim, identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve do të bëhet më evident gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit.

Subjekti, pasi ka përcaktuar faktorët e rrezikut, bën përcaktimin e kategorive të faktorëve të rrezikut.

Me kategori të faktorit të rrezikut do të kuptojmë llojet e klientëve, me të cilët subjekti ka hyrë në marrëdhënie biznesi, llojet e produkteve dhe të shërbimeve që subjekti u ofron klientëve, llojet e transaksioneve dhe marrëdhëniet e biznesit si dhe zona gjeografike prej të cilës klientët janë (prejardhja/vendndodhja) ose kanë marrëdhënie biznesi.

Në vazhdim të procesit të identifikimit të rreziqeve të mundshme, pasi subjekti ka krijuar kategoritë e faktorëve, realizohet procesi i monitorimit të këtyre kategorive, i cili shërben si një nga proceset më të rëndësishme në matjen e rrezikut. Në vijim të procesit të monitorimit realizohet procesi i analizës⁵⁹. Megjithatë, vlerësohet se nuk ekziston një ndarje racionale e mirëfilltë midis procesit të monitorimit dhe procesit të analizës. Të dyja këto procese, për shumë subjekte mund të nënkuptojnë ndërmarrjen e masave të njëjta, por për efekt të këtij udhëzimi do të pranojmë se “analiza” është pjesë e procesit të monitorimit dhe përfshin masat më të përforcuara të tij, duke ruajtur të dhëna / konkluzione me shkrim, të cilat i paraqiten autoriteteve kompetente. Analizimi i transaksioneve përbën bazën e ngritjes së sistemit të PPP/LFT nga subjektet sepse është produkti (*output-i*) i të gjithë këtij procesi. Analizimi i kategorive të faktorëve të rrezikut do të kryhet në bazë të variablave të kategorive.

Me variabël kategorie do të kuptojmë atë element bazë të kategorisë së faktorit, i cili shërben për të gjykuar rreth përputhshmërisë së profilit të klientit me profilin e transaksioneve, si dhe destinacionin e fondeve në mbërritje dhe në nisje.

Identifikimi i faktorëve të rrezikut si dhe kategorive të faktorëve lejon zbatimin e një përjasje të bazuar në rrezik. Kjo **qasje e bazuar në rrezik**, mundëson strukturat e subjektit financiar të përqendrohen në çështje, të cilat mbartin ekspozim më të madh ndaj rrezikut. Subjekti financiar duhet të vlerësojë kapacitetet e tij për të ndërtuar një përjasje të tillë, duke identifikuar dhe vlerësuar “mundësitë”, “dobësitë”, “rreziqet”, si dhe “fuqitë” e tij për të përfituar nga kjo metodologji.

Subjektet duhet të ndërtojnë procese për identifikimin, matjen, monitorimin dhe zbutjen e rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, me qëllim zbatimin e një qasje të bazuar në rrezik. Këto procese duhet të mbështeten nga politika, procedura, struktura të dedikuara, trajnime si dhe sisteme kontrolli të cilat realizojnë identifikimin dhe administrimin në mënyrë efektive të ekspozimit ndaj rrezikut. Kontrolli i brendshëm i subjektit vlerëson, në mënyrë të vazhdueshme, tërësinë e funksionimit të këtyre proceseve. Strukturat më të larta drejtuese të subjektit, aprovojnë sistemin e ndërtuar.

Në rastet kur subjektet identifikojnë ekspozim të lartë ndaj rrezikut, aplikojnë masa të përforcuara për administrimin dhe zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve.

II. Niveli i rrezikut

⁵⁹ Analiza - Identifikimi, vlerësimi, matja si dhe nxjerrja e konkluzioneve lidhur me rrezikun që shoqëron situatën.

Subjektet identifikojnë rrezikun, duke kryer vlerësime ose matje në dy drejtime kryesore:

- në ndikimin (dëmin) që mund të shkaktohet, në rast se ndodh një ngjarje, e cila është shoqëruar ose ka shkaktuar pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe
- në mundësinë e realizimit të ngjarjes, e cila mund të shoqërohet ose shkaktojë pastrim parash apo financim të terrorizmit.

Subjektet vlerësojnë ndikimin (dëmin) e një rreziku të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në varësi të rrethanave individuale, por disa nga pikat kryesore ku subjektet duhet të bazohen në vlerësimin e ndikimit (dëmit) janë:

- ndikimi në veprimtarinë e subjektit financiar, në rastet kur një ngjarje e cila mund të konsiderohet vepër penale, mund të shkaktojë humbje financiare ose në rastin kur subjekti ndëshkohet me gjobë nga autoritetet kompetente;
- ndikimi kur një transaksion i veçantë mund të rezultojë se është përdorur për korrupsion, ryshfet, kontrabandë mallrash, emigrim të paligjshëm, trafikim substancash narkotike, trafik armësh, terrorizëm, vjedhje, përvetësim, mashtrim apo vepra të tjera penale;
- ndikimi kur një transaksion i veçantë mund të shkaktojë vuajtje për shkak të financimit të armëve të shkatërrimit në masë, drogave të paligjshme, etj.;
- ndikimi në reputacionin e subjektit financiar, i cili lidhet me dëmin që mund të shkaktohet subjektit nga përfshirja (qoftë edhe pa qëllim) në një marrëdhënie biznesi apo transaksion, si rezultat i veprimtarive të paligjshme, që mund të çojë në vendosjen e sanksioneve nga organet kompetente ose në largimin e klientëve nga subjekti.

Subjektet, në varësi të vlerësimit të mundësisë apo pasojave që mund të sjellë kryerja e një ngjarjeje, e cila çon në pastrim parash apo financim të terrorizmit, mund të kryejnë vlerësimin e rrezikut në këndvështrime të ndryshme. Pavarësisht kësaj, gjykohet se në përputhje me kuadrin ligjor, dy janë nivelet e kategorizimit të rrezikut:

- **Niveli i ulët dhe niveli i mesëm ose i moderuar i rrezikut** - kur mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi është e vogël dhe/ose të ketë pasoja të vogla ose të papërfillshme për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat ⁶⁰e vigjilencës së thjeshtuar dhe vigjilencës së duhur të parashikuar në ligj apo aktet nënligjore.
- **Niveli i lartë i rrezikut** – kur ekziston mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi dhe/ose të ketë pasoja, të cilat mund të konsiderohen të dëmshme ose shumë serioze për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat e vigjilencës së zgjeruar të parashikuar në ligj apo aktet nënligjore.

Megjithatë, subjektet nga ana e tyre mund të përdorin një përfaqje të tillë, e cila e kategorizon rrezikun në tre nivele: niveli i ulët, i mesëm dhe i lartë, por niveli me rrezik të

⁶⁰ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

ulët dhe niveli me rrezik të mesëm duhet të kanalizohen në kategorinë ⁶¹e vigjilencës së thjeshtuar dhe vigjilencës së duhur.

III. Faktorët e rrezikut

Subjektet konsiderojnë faktorë gjerësisht të pranuar (më të përdorur) të identifikimit dhe matjes së rrezikut, të cilët janë: rreziku gjeografik, rreziku i klientit, si dhe rreziku i produktit dhe shërbimeve/transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit.

Subjektet bazohen në këta tre faktorë, të cilët përbëjnë minimalisht faktorët që shërbejnë për matjen e rrezikut.

Subjekte të ndryshme mund të aplikojnë pesha ponderimitë ndryshme për këta faktorë (individualisht apo në kombinim) në vlerësimin e rrezikut, në varësi të aktivitetit dhe rrethanave përkatëse. Rrjedhimisht, subjektet do të duhet të bëjnë përcaktimin e këtyre peshave dhe arsyetimin përkatës për madhësinë e peshave të zgjedhura / aplikuar. Këto peshë janë subjekt i vlerësimit gjatë kontrolleve në vend, në përputhje me profilin, strategjinë si dhe vizionin e subjektit. Në vijim peshat e ponderimit që përfton çdo faktor rreziku, do ti përkufizojmë si “koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut”.

Të gjitha kategoritë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe udhëzimet përkatëse, të cilat kanalizohen në procesin e vigjilencës së zgjeruar, mbartin vlerën e rrezikut më të lartë pra koeficientët e ponderimit më të lartë. Kjo nënkupton që rezultati i sistemit të ndërtuar nga subjekti duhet të kanalizojë automatikisht marrëdhënien e biznesit me klientin në kategorinë e Vigjilencës së Zgjeruar. Për shembull, në rastin që një PEP kryen një transaksion, marrëdhënia kanalizohet automatikisht në procesin e vigjilencës së zgjeruar dhe si rrjedhim, subjekti duhet të marrë të gjitha masat në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Nuk ka një metodologji të vetme për të zbatuar faktorët e rrezikut. Aplikimi i tyre (faktorëve) ka për qëllim të ofrojë një strategji për administrimin e rreziqeve të mundshme dhe këta faktorë konsiderohen të jenë tregues të dobishëm, por jo domosdoshmërisht, për të gjitha rastet apo rrethanat.

Subjektet ndërtojnë sistemet e tyre, në mënyrë të tillë që identifikojnë minimalisht faktorët dhe kategoritë e përcaktuara në këtë udhëzim, të cilat mbartin nivelin më të lartë të rrezikut. Subjektet mund të përcaktojnë edhe kategori ose faktorë të tjerë në përputhje me profilin e tyre të segmentimit në tregjet financiare.

1. Faktori “Rreziku gjeografik” – është rreziku i përcaktuar nga pozicioni gjeografik i vendit të origjinës së klientit (pronarit përfitues) dhe / ose vendndodhjes së personit të përfshirë në një transaksion me klientin.

Kategoritë e rrezikut gjeografik të cilat mund të rezultojnë në konstatimin se një vend paraqet një rrezik më të lartë përfshijnë:

- vende që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme, si për shembull vende/entitete/persona të cilët janë të përfshirë në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

⁶¹ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

- vende që identifikohen nga burime të besueshme se kanë mungesa të kuadrit ligjor dhe rregullativ të PPP/LFT të tilla si vende të cilat janë identifikuar nga FATF, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Moneyval, Banka Botërore, Egmont Group etj.;
- vende të identifikuara nga burime të besueshme informacioni si ofrues të fondeve apo përkrahës për aktivitetet terroriste që kanë krijuar organizata terroriste që veprojnë brenda tyre;
- vende të identifikuara nga burime të besueshme, që kanë nivele të konsiderueshme korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër kriminal si vende të identifikuara nga Banka Botërore, FMN ose FATF.

Vlerësimi dhe matja e rrezikut varen gjithashtu edhe nga vendndodhja e subjektit ose vendndodhja e njësisë organizative të tij, duke nënkuptuar nivel të ndryshëm të rrezikut të subjekteve të vendosura në një zonë që vizitohet nga shumë turistë, krahasuar me ato të një zone rurale, ku të gjithë klientët njihen personalisht.

Rreziku mund të jetë në nivel më të lartë në pikat kufitare, aeroporte, në vendet me përqendrim të lartë të huajve ose në rastet e transaksioneve që përfshijnë të huajt (për shembull panairë), në vendet ku janë vendosur ambasadat apo zyrat konsullore, në vendet me rrezik të lartë të korrupsionit dhe krimit etj..

Rrezik të lartë paraqesin gjithashtu edhe transaksionet e ekzekutuara në destinacionet *off-shore*.

2. Faktori “Rreziku i klientit / entitetit – Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut bëhet, duke u bazuar mbi mundësinë që subjekti të përdoret nga klienti me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose që klienti të përdorë biznesin e tij me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.

Subjektet ndërmarrin masa shtesë për ato klientë të klasifikur me rrezik të lartë. Natyra dhe tërësia e masave të marra, varet nga rrethana të caktuara konkrete (për shembull, nëse një klient është vlerësuar me rrezik të lartë për shkak të strukturës së pronësisë së tij, subjektet duhet të përfshijnë një dispozitë në procedurat e tyre, që të përcaktojë nevojën e marrjes së të dhënave shtesë dhe verifikimin e mëtejshëm të dokumenteve të paraqitura).

Në zbatimin e parimeve gjerësisht të pranuar, si dhe mbështetur në përvojën e tyre, subjektet janë të pavarura në përcaktimin e përjasjes së tyre ndaj rrezikut të klientit.

Kategoritë e klientëve, veprimtaritë e të cilëve mund të jene tregues i nivelit të rrezikut më të lartë, listohen si më poshtë:

- a) klientë që kryejnë marrëdhënien e tyre të biznesit në rrethana të pazakonta të tilla si:
 - distancë e konsiderueshme dhe e pashpjegueshme gjeografike midis subjektit dhe vendndodhjes së klientit,

- lëvizje të shpeshta dhe të pashpjegueshme të llogarive në institucione të ndryshme dhe lëvizje e shpeshtë dhe e pashpjegueshme e fondeve ndërmjet institucioneve në vende të ndryshme gjeografike,
 - klientë të cilët kanë një strukturë, natyrë apo marrëdhënie biznesi komplekse, që e bën të vështirë identifikimin e pronarit të vërtetë dhe strukturave kontrolluese;
- b) organizata jofitimprurëse;
 - c) persona të ekspozuar politikisht (PEP);
 - d) transaksione me klientët jorezidentë;
 - e) marrëdhënie biznesi dhe transaksione me klientë, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë në vende që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare të PPP/LFT;
 - f) transaksione në emër të një personi tjetër;
 - g) klientë që kryejnë lëvizje në shuma të mëdha *cash*;
 - h) struktura e pronësisë së kompanisë duket e pazakontë ose tepër komplekse, duke pasur parasysh natyrën e biznesit të kompanisë;
 - i) krijimi i shpeshtë dhe i papritur i marrëdhënieve të ngjashme të biznesit me disa banka, pa marrë parasysh vlerësimet ekonomike. Një shembull i veprimtarive të tilla mund të jetë hapja e llogarive në disa banka, hyrja në disa marrëveshje të anëtarësimit në fondet vullnetare të pensioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe (me një ose më shumë kompani administrimi), ose nënshkrimi i disa marrëveshjeve të *leasing-ut* financiar me disa ofrues të ndryshëm të *leasing-ut* financiar etj.;
 - j) transferime të shpeshta dhe të papritura të fondeve nga llogaritë në një bankë në ato të një banke tjetër, pa një arsyetim të qartë ekonomik, veçanërisht kur bankat janë vendosur në vende të ndryshme gjeografike;
 - k) klientë që kryejnë veprimtari të biznesit që karakterizohen nga një qarkullim i madh i parasë dhe pagesave *cash*, në nivele të konsiderueshme, të tilla si: restorante, pika karburanti, zyrat e këmbimit valutor, kazino, dyqanet e lavazhit të makinave, dyqanet e luleve, tregtarët e mallrave me vlerë të lartë (metale të çmuar, gurë të çmuar, automjete, objekte arti etj.), transportuesit e mallrave dhe të pasagjerëve, kompani bastesh sportive;
 - l) tregtarët dhe prodhuesit e armëve;
 - m) përfaqësuesit e palëve, biznesi i të cilëve përfshin përfaqësimin (avokatët, kontabilistët ose përfaqësues të tjerë profesionalë), veçanërisht kur subjekti është në kontakt vetëm me përfaqësuesit;
 - n) kompanitë e ndërtimit;
 - o) kompanitë me një numër të vogël punonjësish që nuk janë në proporcion të drejtë me fushën e tyre të biznesit, kompanitë pa infrastrukturë ose pa mjedise biznesi etj.;
 - p) personat të cilëve iu është refuzuar oferta e biznesit nga një tjetër subjekt, pavarësisht nga mënyra si është marrë një informacion i tillë, dhe / ose personat me reputacion jo të mirë;

- q) klientë të cilët kanë fonde nga burime të të paqarta ose të paidentifikuara, dhe / ose klientë me fonde nga burime të paverifikueshme;
- r) klientët e dyshuar që nuk veprojnë për llogari të tyre dhe / ose që zbatojnë udhëzimet e një personi të tretë;
- s) *trustet* dhe shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit/shoqëritë që merren me import/eksport;
- t) nëpunës në nivel të lartë administrimi.

Subjektet, pasi kanë kryer identifikimin dhe verifikimin e klientit/pronarit përfitues (vendosjes së marrëdhënies së biznesit), strukturat përgjegjëse, klasifikojnë klientin në kategorinë e duhur në bazë të profilit të tij, si dhe përcaktojnë nivelin e rrezikut. Subjekti është i detyruar të kryejë këtë proces edhe për klientët ekzistues. Në këtë udhëzim, janë përcaktuar vetëm kategoritë të cilat klasifikohen si kategori me rrezik të lartë. Subjektet, krahas kategorive të përcaktuara në këtë udhëzim, përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilëve duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. Të gjitha kategoritë të cilat nuk përfshihen në nivelin me rrezik të lartë, kategorizohen në nivelin e rrezikut të ulët dhe të mesëm ose të moderuar.

Subjektet (strukturat përgjegjëse), nëse gjatë vazhdimit të marrëdhënies së biznesit ose gjatë procesit të monitorimit, evidentojnë se klienti kryen një aktivitet jo në përputhje me profilin e tij, janë të detyruara të analizojnë arsyet që kanë sjellë këtë ndryshim në profilin e klientit. Nëse gjykohet e arsyeshme, strukturat përgjegjëse marrin vendim për të riklasifikuar kategorinë e klientit në një nivel më të lartë rreziku, si dhe e kanalizojnë në një proces më të thellë monitorimi. *Subjektet rekomandohen të përcaktojnë procedura të brendshme lidhur me përditësimin e profilit të rrezikut të klientëve edhe nëse klientët nuk shfaqin një profil aktiviteti ndryshe nga ai fillestar.*

Nëse klienti nuk është i klasifikuar në nivelin me rrezik të lartë, por përdor produkte të klasifikuara si produkte me rrezik të lartë ose kryen marrëdhënie biznesi me destinacione të përfshira në rrezikun gjeografik, rasti përsëri kanalizohet në një proces më të thellë monitorimi dhe analizimi-vigjilencë të zgjeruar. Pra, përsëri, rezultati i ponderimit të faktorëve të rrezikut duhet të rezultojë në nivelin e lartë të rrezikut.

Subjektet analizojnë me përparësi rastet kur klienti, njëkohësisht, kategorizohet si klient me rrezik të lartë, përdor produkte me rrezik të lartë apo plotëson kushtet e rrezikut gjeografik, dhe kanalizojnë në një proces më të thellë përditësimi informacioni, duke kryer monitorim në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, subjekti duhet të ruajë të dhënat e klientit, të cilat i paraqiten autoriteteve kompetente të fillojë menjëherë të shqyrtojë procedurat për raportim në autoritetin përgjegjës, nëse nga analiza e mirëfilltë rezulton një rrezik potencial.

Vlerësimi i rrezikut duhet konsideruar si një funksion i tre faktorëve të rrezikut. Faktorëve u bashkëngjiten *koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut*. Në bazë të koeficientëve të ponderimit, subjektet mund të vendosin të ponderojnë më shumë një faktor rreziku. Si rezultat, funksioni do të mbivlerësojë një faktor dhe do të nënvlerësojë një faktor tjetër. Mbivlerësimi apo nënvlerësimi duhet të jetë në përputhje me profilin e strategjisë të ndërtuar nga subjekti lidhur me masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Një çështje tjetër që duhet konsideruar është se të tre këta "faktorë" mund të jenë të lidhur pozitivisht me njëri-tjetrin, që nënkupton se, në rastin e një klienti, "jo

rezident” nga destinacioni *off-shore*, ai është në të njëjtën kohë kategori me rrezik të lartë si në bazë të kriterit të rrezikut të klientit ashtu edhe në bazë të kriterit të rrezikut gjeografik (nëse ka kryer transaksione në destinacione *off-shore*). Analiza cilësore që do t'i kryhet rastit do të konsiderohet thelbësore, ndërsa analiza sasimore shërben si tregues potencial i ekspozimit ndaj rrezikut.

3. Rreziku i produkteve dhe shërbimeve/kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit.

Subjektet, kryejnë klasifikimin sipas produkteve/transaksioneve dhe shërbimeve, duke gjykuar mbi mundësinë që këto të fundit të përdoren nga klienti, me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit ose me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.

Kategoritë të cilat paraqesin një nivel të lartë rreziku janë:

- a) shërbimet e identifikuara nga ana e autoriteteve kompetente ose burime të tjera të besueshme si potencialisht me rrezik të lartë:
 - shërbimet bankare korrespondente ndërkufitare,
 - shërbimet bankare korrespondente me banka, llogaritë e të cilave përdoren nga bankat guaskë,
 - transaksionet komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor,
 - transaksione nëpërmjet zhvillimeve të reja teknologjike;
- b) shërbime të reja në treg, pra shërbime që nuk janë ofruar më parë në sektorin financiar, të cilat duhet të monitorohen posaçërisht në mënyrë që të përcaktohet shkalla reale e rrezikut që shoqëron ato (shërbimet);
- c) bankingu privat ndërkombëtar, pra sigurimi i bankingut privat dhe shërbimet e administrimit të fondeve për shtetas të huaj (Bankingu privat potencialisht përfshin rreziqe të konsiderueshme për shkak se një klient i cili mund të ketë shuma të mëdha parash në dispozicion, shërbehet nga një punonjës i vetëm banke ose një grup i vogël punonjësish të bankës, të cilët mund të jenë udhëzuar nga drejtuesit e tyre për të plotësuar të gjitha kërkesat e klientit dhe/ose pavarësisht abuzimeve dhe mashtrimeve me detyrën që drejtuesit mund të bëjnë);
- d) e-banking në rastet e parashikuara nga subjekti në procedurat e tij;
- e) dorëzimi elektronik i urdhrave të tregtimit të titujve, në rastet e parashikuara nga subjekti në procedurat e tij;
- f) ofrimi i shërbimit për të hapur llogari të përbashkëta, të cilat mobilizojnë fonde nga burime dhe klientë të ndryshëm, të depozituar në një llogari të regjistruar në një emër;
- g) riblerje ose pagesa e çeqeve ose një instrumenti tjetër bartës ose të letrës me vlerë;

- h) përdorimi i teknologjive moderne që ofrojnë anonimitet (për shembull ATM, *internet banking*, *mobile banking*, *prepaid card*, ⁶²mjete virtuale, etj.).

IV. Variablat e kategorisë

Subjektet, për të vlerësuar kategoritë e faktorit duhet të kenë parasysh minimalisht variablat e mëposhtëm, të cilët mund të vlerësohen individualisht ose të kombinuara midis tyre:

- a) **Qëllimi i hapjes së një llogarie ose të një marrëdhënieje biznesi** - Informacioni që subjektet mbledhin për hapjen e llogarisë tregon qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe zhvillon profilin e rrezikut. Diferenca e mundshme midis profilit të klientit (rrezikut të klientit) dhe profilit të produkteve (rrezikut të produkteve) që ai përdor, tregon një anomali të mundshme të qëllimit të hapjes së llogarisë. Hapja e një llogarie, për të kryer transaksione rutinë, me vlera jo shumë të larta nga një klient i njohur mund të paraqesë një rrezik të ulët krahasuar me një llogari të hapur për të kryer transaksione me vlera të larta nga një klient i panjohur ose i rastësishëm.
- b) **Niveli i aktiveve ose madhësia e transaksioneve** – ekzistenca e pasurive, apo kryerja e transaksioneve me vlera shumë më të larta në krahasim me atë që mund të pritet nga profili i klientit, shërben si sinjal që një klient të vlerësohet potencialisht si me rrezik të lartë dhe duhet të trajtohet si i tillë.
- c) **Niveli i rregullimit ose regjime të tjera ligjore të kontrollit ose të qeverisjes ku klienti është subjekt** - një institucion financiar që rregullohet në një vend me një regjim ligjor, i cili nuk zbaton ose zbaton pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, për të parandaluar e luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, paraqet më shumë rrezik se një subjekt që i nënshtrohet vetëm rregullave minimale kundër pastrimit të parave. Kompanitë dhe filialet (tërësisht në pronësi të tyre) që janë në pronësi publike dhe që tregtojnë në bursë, paraqesin në përgjithësi rreziqe minimale të pastrimit të parave. Për shembull, një kompani e cila e ka qendrën në destinacione *off-shore* paraqet rrezik më të lartë se një kompani me qendër në një vend me regjim ligjor, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- d) **Kohëzgjatja e marrëdhënieve të biznesit** – marrëdhëniet afatgjata gjatë së cilave përfshihen kontakte të shpeshta të klientit, mund të paraqesin rrezik më të ulët nga pikëpamja e pastrimit të parave.
- e) **Burimi i fondeve.**
- f) **Dokumentacioni justifikues për transaksionet.**

V. Hapat e matjes së rrezikut

Subjektet ndjekin hapat e mëposhtme për matjen e ekspozimit ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit:

⁶² Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

- a) Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i marrëdhënieve të biznesit me klientin, bazuar në profilin e transaksioneve, profilin e klientit dhe profilin e ekspozimit ndaj rrezikut gjeografik, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për tërësinë e variablave të kategorive. Në këtë hap, klientët, produktet dhe shërbimet që ata përdorin si dhe destinacionet e produkteve janë të klasifikuar ⁶³në kategori të vigjilencës së thjeshtuar, vigjilencës së duhur dhe të vigjilencës së zgjeruar. Në çdo ndryshim të mundshëm të variablave të kategorive, subjektet vlerësojnë rrezikun. Subjekti, pasi është identifikuar një ndryshim potencial i variablave, vlerëson rezultatin për të tre kriteret e rrezikut, duke zhvilluar analizën sasiore të rastit. Analiza sasiore nënkupton shumën e faktorëve të rrezikut, ku secili faktor është ponderuar me koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut.
- b) Subjektet, në rast se rezultati (analiza sasiore) tregon për një rrezik të mundshëm, e mbështesin analizën në tërësinë e ekspozimit ndaj kriterëve të rrezikut (analiza cilësore), si dhe mbi variablat e kategorisë së faktorit. Disa prej masave shtesë për të administruar këtë ekspozim janë:
- informacion shtesë për profilin e klientit (Internet, baza të dhënash publike);
 - rritje e frekuencës së përditësimit të të dhënave për klientin;
 - Informacion shtesë për natyrën e synuar të marrëdhënieve të biznesit, duke kërkuar dokumentacion justifikues;
 - marrjen e informacionit shtesë për burimin e fondeve;
 - marrjen e informacionit shtesë për arsyet dhe qëllimin e këtij transaksioni ose grupit të transaksioneve;
 - marrja e miratimit nga drejtuesit e lartë për nisjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton se klienti apo pronari përfitues ka ndryshuar kategori;
 - monitorim i zgjeruar.

Subjektet mund të përcaktojnë masa të tjera shtesë për administrimin kundrejt këtij ekspozimi. Në këtë hap, subjekti duhet të ketë nxjerrë përfundime sasiore dhe cilësore, duke ruajtur të dhëna vërtetuese. Mund të rezultojë që një rast i veçantë të mos identifikohet nga treguesit sasiore por kjo nuk është e mjaftueshme që subjekti të mos ketë identifikuar në bazë të variablave cilësore.

Metodologjia e matjes së rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që është ofruar në këtë udhëzim, përfaqëson një metodë mikse sasiore dhe cilësore, ku analiza sasiore nuk do të kishte kuptim pa analizën cilësore.

- c) Strukturat përgjegjëse të subjektit, pasi kanë identifikuar një rast, i cili përfaqëson materialitet, ndjekin hapat për materializimin e dyshimit të arsyeshëm, si dhe marrin të gjitha masat e nevojshme nëse çështja kërkon adresim në Autoritetin Përgjegjës.

Në aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi, paraqitet një model i thjeshtë për të mundësuar materializimin e kërkesave të vlerësimit sasiore dhe cilësor.

⁶³ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

VI. Treguesit e dyshimtë

Subjektet konsiderojnë tregues të dyshimtë, veprimet të cilat për nga natyra mund të konsiderohen të pazakontë për marrëdhënien e biznesit dhe shërbejnë si shenja për të filluar një procedurë vlerësimi të rrezikut, në çdo rast kur evidentohen këto tregues.

Treguesit e dyshimtë kanë për qëllim të ndihmojnë subjektet për vlerësimin/matjen për shenja të mundshme të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit dhe të reduktojnë kufijtë e pasigurisë lidhur me vlerësimet subjektive apo sjelljet diskrete, si dhe të kontribuojnë në sigurimin e përmbushjes së saktë dhe homogjene të detyrimeve të raportimit të transaksioneve të dyshimta.

Lista e treguesve të anomalisë nuk është shteruese, duke marrë parasysh, ndër të tjera, evoluimin e vazhdueshëm të procedurave për kryerjen e transaksioneve.

Subjektet duhet të vlerësojnë me vëmendje modele të tjera të sjelljes, të cilat edhe pse nuk janë përshkruar në treguesit e dyshimtë, mund të përbëjnë anomali.

Treguesit e dyshimtë, të cilët renditen më poshtë, përfshihen në **nivelin e lartë të rrezikut** dhe ndaj tyre duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar të parashikuara në ligj apo aktet nënligjore:

1. Tregues të dyshimtë që lidhen me klientin:

- a) klienti refuzon ose nuk jep lehtë informacionin e kërkuar ose jep informacion të rremë ose ndryshon informacion shpesh dhe pa ndonjë justifikim të qartë;
- b) klienti jep informacion përgjithësisht të ndryshëm nga ai i dhënë nga burime të pavarura, si për shembull informacion i marrë nga arkivat, listat dhe regjistrat ose të dhëna të publikuara në faqet zyrtare të internetit ë të autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- c) klienti, nisur nga kërkesa e institucionit financiar për informacion të mëtejshëm, zgjedh që të mos kryejë transaksionin, ose të mos vendosë marrëdhënie biznesi apo të kërkojë ndërprerjen e marrëdhënies ekzistuese;
- d) klienti sillet në një mënyrë të pazakontë, krahasuar me standardet normale të sjelljes së klientëve, pa dhënë ndonjë justifikim të qenësishëm;
- e) klienti shmang kontaktet direkt me institucionin financiar, duke autorizuar dhe dhënë fuqi veprimi në mënyrë të shpeshtë dhe jo konsistente me aktivitetin që kryen;
- f) klienti i drejtohet një institucioni financiar ose një dege të tij që është larg zonës së tij të rezidencës ose në të cilën kryen aktivitetin dhe ndryshon shpesh degën që përdor.
- g) klienti pyet në mënyrë të përsëritur në lidhje me procedurat mbi aplikimin e rregullave kundër parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe përpiqet të shtyjë stafin t'i anashkalojë këto rregulla, duke u përpjekur njëkohësisht të vendosë marrëdhënie konfidenciale me punonjësit;

- h) klienti tregon se nuk ka njohuri të përshtatshme mbi natyrën, objektin, shumën apo qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, ose jep shpjegime jo realiste, konfuze ose jo konsistente, të cilat të bëjnë të dyshosh se mund të jetë duke vepruar për një person të tretë;
- i) klienti gjatë kryerjes së procedurave për të kryer transaksione, paraqitet gjithnjë i shoqëruar nga persona të tjerë, të cilët duken tërësisht të interesuar ndaj transaksionit;
- j) klientët të cilët janë shtetas të huaj, veçanërisht persona të ekspozuar politikisht, përdorin marrëdhënien e vendosur në Shqipëri, ekskluzivisht për transferta në hyrje ose në dalje, pa justifikime ekonomike, edhe pse këto transaksione mund të kryhen në vendin e klientit me kosto më të ulët dhe në një kohë më të shkurtër; ;
- k) klienti kryen transaksione të mëdha në *cash*, ose nëpërmjet procedurave të pazakonta kur është bërë e njohur se është subjekt i procedimit penal, masave parandaluese ose sekuestrimit të mallit, ose është në kontakt të ngushtë (për shembull pjesëtar i familjes) me njerëz ndaj të cilëve janë marrë këto masa ose kur pala tjetër e transaksionit është subjekt i këtyre masave;
- l) aplikimet për kredi nga personat të cilët dyshohen se mund të bëhen pjesëtarë të organizatave kriminale për qëllime të riinvestimit të të ardhurave të krimit në prona;
- m) klienti ka rezidencën, ose kryen transaksione me palë të cilat janë të vendosura në vende ose territore me rrezik të lartë dhe kryejnë transaksione të mëdha me procedura të pazakonta, pa justifikime të qenësishme;
- n) klienti nuk paraqet detaje në lidhje me palët e treta për të cilat po vepron;
- o) klienti kryen transaksione të shpeshta dhe të mëdha të cilat nuk janë konsistente me profilin e tij ekonomik apo të transaksionit;
- p) klienti përfiton transferta në llogarinë e tij nga palë të treta të ndryshme, të cilat nuk janë të justifikuara nga natyra e biznesit të tij;
- q) urdhëruesi, në një transfertë i bën rezistencë ose përpiqet të anashkalojë kërkesat e përputhshmërisë të bankës marrëse me qëllim identifikimin e detajeve dhe të dhënave të transaksionit;
- r) klienti, person fizik ose juridik, megjithëse është këshilluar mbi kërkesat e identifikimit, refuzon ose nxjerr pengesë në dhënien e tyre për të përcaktuar identitetin e tij ose përpiqet të nxisë punonjësin e bankës për të mos i regjistruar këto të dhëna, ose refuzon të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për transaksionin ose kërkon përjashtime nga kërkesat për të ruajtur të dhënat e tij.

2. Tregues të dyshimtë që lidhen me transaksionet:

- a) kërkesa për transaksione të cilat kryhen pa marrë parasysh vlerësimin për rrezikun e investimit, komisionet e vendosura ose kosto të tjera;
- b) urdhra të përsëritura për transaksione nga kompani që rezultojnë rregullisht me humbje ose në vështirësi financiare, të cilat vazhdojnë të kenë të njëjtin administrim pavarësisht ndryshimeve të herëpashershme të pronarëve;
- c) marrje të shpeshta të fondeve nga subjekte të ndryshme të shoqëruara me transferta të urdhëruara nga klientë në lidhje me llogari të cilat janë pronë e *trusteve*;
- d) transaksione të mëdha në mënyrë të përsëritur me palë të cilat janë kompani të sapokrijuara dhe që kanë objekt të veprimtarisë së tyre veprimtari që nuk përputhet me aktivitetin e klientit ose që kanë qëllim të përgjithshëm.
- e) transaksione të pazakonta me praktikat aktuale të tregut ose që ndikohen nga procedura dhe instrumente veçanërisht të ndryshëm nga ato të operatorëve të tjerë aktivë në atë fushë, veçanërisht nëse janë shumë komplekse ose kanë të bëjnë me transferta të shumave të mëdha, që nuk justifikohen nga nevoja të caktuara;
- f) transaksione të papritura, të realizuara brenda periudhave të caktuara, të kryera në lidhje me marrëdhënie të cilat funksionojnë rregullisht, nëpërmjet çeqeve për shuma të mëdha ose depozitimin e çeqeve, shumat e të cilave janë transferuar ndaj palëve të treta;
- g) fonde nga jashtë, në shuma të mëdha dhe të shpeshta në drejtim të llogarive ose marrëdhënieve të vendosura në Shqipëri nga kompani që kanë pronar persona me qendër në vende me rrezik të lartë ose që tregojnë transaksione jo tipike të biznesit apo aktivitetit dhe që shoqërohen nga tërheqje të mëdha *cash* nga këto vende;
- h) transaksione që nuk përputhen me instrumentet e përdorur me aktivitetin ekonomik ose profilin ekonomik apo financiar ose në rast të personave juridikë, apo të një grupi, këto transaksione nuk janë të justifikuara si duhet nga klienti;
- i) përdorimi i llogarive të shoqërive ose ndërmarrjeve nga ana e aksionerëve, drejtorëve ose punonjësve për transaksione të cilat nuk janë pjesë e biznesit të shoqërive/ndërmarrjeve, veçanërisht transaksione në *cash* ose për shuma të mëdha;
- j) përdorimi i llogarive në emër të individëve (aksionerëve, drejtorëve punonjësve ose klientëve apo të afërmëve të tyre) për transaksione në interes të shoqërisë ose ndërmarrjes, veçanërisht transaksione në *cash* ose për shuma të mëdha;
- k) transaksione të mëdha nga persona të cilët nuk merren me aktivitet ekonomik ose janë në vështirësi ekonomike;
- l) transaksione të shpeshta ose të mëdha nga klientë në emër ose në favor të personave të tretë ose nga persona të tretë në emër apo në favor të një klienti, kur marrëdhëniet personale, tregtare ose financiare midis palëve janë të

pashpjegueshme, veçanërisht nëse këto transaksione duket se janë ndërtuar për të mos stimuluar një lidhje me transaksionet e tjera;

- m) transaksione të autorizuar nga një ose më shumë persona me prokurë, karakteristikat dhe qëllimet e të cilëve nuk lidhen me aktivitetin ekonomik të klientit;
- n) transaksione të përsëritura, veçanërisht për shuma të konsiderueshme, të autorizuar në lidhje me marrëdhënie ku janë të përfshirë të mitur, persona në moshë ose me aftësi të kufizuar.
- o) ⁶⁴transaksione që përfshijnë përdorimin e mjeteve virtuale.

3. Transaksionet *Cash*:

- a) depozitat dhe tërheqjet në shuma të mëdha parash (*cash*) të pa justifikuar nga profili ekonomik i transaksioneve të klientit;
- b) kur në një llogari është kredituar një sasi e madhe parash (*cash*) nga palë të treta, pa dijeninë e mbajtësit të llogarisë;
- c) ekzistenca e një numri të madh veprimesh në një llogari, me depozita dhe tërheqje të shumta nëpërmjet lëshimit të çeqeve, ndërkohë që balanca e llogarisë mbahet në nivele të ulëta;
- d) riaktivizimi i llogarive të fjetura (jo aktive), sidomos duke përdorur depozitat *cash* nëpërmjet degëve të ndryshme nga dega në të cilën është hapur llogaria;
- e) sasi të mëdha të kartëmonedhave me prerje të vogla që shkëmbehen me kartëmonedha me prerje më të mëdha;
- f) kreditime të shpeshta të llogarisë nëpërmjet kartëmonedhave në prerje të mëdha;
- g) kreditime të shpeshta të llogarisë nëpërmjet valutës së huaj, në rast se ky veprim është jo tipik për sipërmarrje në sektorin e caktuar të aktivitetit;
- h) kreditime të shpeshta të llogarisë me vlerë të vogël në një llogari të vetme, totali i të cilave arrin një vlerë të konsiderueshme;
- i) rritje e pashpjegueshme në vëllimin e transaksioneve *cash* në degë të caktuara të bankës;
- j) klient, i cili ka një histori të paraqitjes së kartëmonedhave të falsifikuara, çeqeve të papaguara ose çeqeve të paraqitura për t'u paguar në një datë më të largët se data e lëshimit;

⁶⁴ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

- k) klient, i cili lëshon çeqe bankare kundrejt *cash*-it ose blen çeqe “udhëtimi” me vlerë të madhe;
- l) klient, i cili mban disa llogari në të njëjtën bankë dhe kryen depozita në *cash* në secilën prej këtyre llogarive, totali i të cilave arrin një vlerë të konsiderueshme;
- m) disa persona bëjnë pagesa në të njëjtën llogari të mbajtur nga një person fizik, pa ndonjë qëllim të dukshëm ekonomik;
- n) tërheqje të mëdha në *cash* nga një llogari jo aktive më parë ose nga një llogari e cila sapo është kredituar në një vlerë të konsiderueshme nga jashtë vendit;
- o) pagesa e një sasive të madhe parash me qëllim për të marrë pjesë në rritjen/shtimin e kapitalit të një kompanie;
- p) klient, i cili përdor kartën e tij të kreditit për të kryer transaksione me vlerë të madhe dhe më pas e shlyen kredinë në *cash*, pa ndonjë shpjegim të qenësishëm përse i përket prejardhjes së fondeve;
- q) klient, i cili nuk arrin të sigurojë dokumentet mbështetëse për depozitat e mëdha dhe të shpjegojë prejardhjen dhe përdorimin e fondeve;
- r) klient, i cili ushtron profesionin e avokatisë dhe përdor llogaritë e tij, për të kryer transaksione në emër dhe për llogari të personave fizikë dhe juridikë të cilët ai përfaqëson.

4. Transaksionet në instrumentet financiare:

- a) transaksionet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve financiare që nuk përputhen me profilin financiar dhe ekonomik të klientit ose të cilat kryhen nëpërmjet procedurave jo të zakonshme, veçanërisht për shuma të mëdha parash të pajustificuara nga procedura të veçanta;
- b) blerja e instrumenteve financiare (veçanërisht të njësisive të investimeve të pronave të paluajtshme) me çmime dukshëm më të larta se ato të tregut;
- c) transaksione të shpeshta në instrumente financiare, duke përfshirë ndarje transaksionesh, për shuma të mëdha që shlyhen në *cash* ose që nuk kalojnë në llogarinë apo nëpërmjet marrëdhënies së klientit;
- d) investime të shpeshta dhe të mëdha në instrumente financiare, të cilat paguhen nga subjekte/ndërmjetës që ndodhen në vende me rrezik të lartë;
- e) investime të shpeshta afatgjata në instrumente financiare që ndiqen nga kërkesa të menjëhershme për likuidimin e pozicionit dhe transferimin e të ardhurave;
- f) blerja në një masë të konsiderueshme e një instrumenti financiar shumë likuid që ndiqet nga kërkesa për kredi të garantuar nga këto instrumente;
- g) blerje dhe shitje të herëpashershme të instrumenteve financiare, nga dy ose më tepër persona, veprim i cili nënkupton një bashkëpunim në transferimin e

fondeve, veçanërisht nëse transaksionet kryhen me çmime të ndryshme nga ato të tregut dhe që fillojnë dhe përfundojnë në kohë të shkurtra dhe përshijnë instrumente që tregtohen pak;

- h) transaksione me instrumente financiare që karakterizohen nga regjistrimi në emër të personave të tretë ose nga ndërhyrje e personave, të cilët nuk janë të justifikuar në ndonjë mënyrë nga marrëdhënia ndërmjet palëve;
- i) klienti ka për qëllim të blejë tituj të tregtueshem normalisht në treg dhe refuzon të plotësojë kriteret e identifikimit si dhe të paraqesë dokumentet e duhura të verifikimit;
- j) blerja e sasive të mëdha të instrumenteve financiare me kërkesa për regjistrim në emër të personave të tretë të lidhur ose jo;
- k) transaksione të shumta dhe të shpeshta që lidhen me marrjen dhe shlyerjen e instrumenteve financiare, të cilat i përkasin personave të ndryshëm dhe që shlyhen në të njëjtën llogari në emër të një *trusti*;
- l) blerje të shpeshta dhe të mëdha të instrumenteve financiare të kryera në emër dhe për llogari të rezidentëve të vendeve me rrezik të lartë;
- m) blerje të shpeshta dhe të mëdha që lidhen me instrumente financiare të pa materializuara, sidomos me instrumente titujsh, në mungesë të një justifikimi të pranueshëm;
- n) blerja e instrumenteve financiare të pamaterializuar të shoqëruar në të njëjtën kohë me kërkesën për dërgesë fizike ose për transferim tek palë të treta jashtë vendit;
- o) paraqitja e instrumenteve financiare të pamaterializuara për t'u kthyer në *cash* ose për blerjen e instrumenteve të tjera pa kryer transaksionin nëpërmjet llogarisë së klientit ose paraqitja e tyre për t'u depozituar me kërkesën për të dhënë një faturë.
- p) klienti paraqet vështirësi për të sjelle dokumentacionin e nevojshëm për të përcaktuar profilin e tij ekonomik ose të transaksionit;
- q) një përfaqësues i shoqërisë, i cili përpiqet të përfundojë një marrëveshje në emër të shoqërisë, refuzon të japë informacion ose jep informacion të pamjaftueshëm në lidhje me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të shoqërisë, selinë, pronësinë ose kontrollin, identitetin e personave fizikë që janë përfituesit realë, vëllimit të pritshëm të aktivitetit në llogari ose informacion tjetër të kërkuar, ose edhe pse i kërkohet nga institucioni financiar refuzon të pajisë këtë të fundit me dokumentacionin verifikues.
- r) depozitat e përsëritura ose tërheqjet e shumave, të cilat janë në mënyrë të vazhdueshme pak më të ulëta se kufiri i identifikimit të raportuar;

- s) transferta të shpeshta të aksioneve të shoqërive *off-shore* ose kompanive që emetojnë aksione, të cilat janë pronarë të paignifikueshëm dhe që çojnë në pamundësinë për të identifikuar pronarin përfitues.
- t) aktivizimi i papritur i një biznesi joaktiv, veçanërisht në rastet e kompanive *off-shore* ose kompanive që emetojnë aksione, të cilat kanë pronarë të paignifikueshem (*bearer shares*).

5. Transferimi i fondeve:

- a) depozitime të shpeshta të klientit në llogari të ndryshme, konsolidohen në një të vetme dhe transferohen jashtë vendit, veçanërisht “në drejtim të” dhe “nga” një vend që vlerësohet si një vend favorizues në drejtim të sistemit tatimor ose që nuk aplikon sa duhet rekomandimet e FAFT, ose konsiderohet si një vend me rrezik të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- b) llogaritë janë hapur nën emra të personave fizikë ose juridikë dhe nuk tregojnë aktivitet normal të vazhdueshëm me profilin ekonomik dhe profilin e transaksioneve të llogarisë, por janë përdorur ekskluzivisht për transferimin e fondeve jashtë vendit;
- c) transferta fondesh të vazhdueshme për shuma të mëdha nga/për vende me taksa të ulëta dhe që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare që lidhen me sekretin ose nga/për territore me rrezik të lartë, pa pasur një qëllim të dukshëm biznesi lidhur me aktivitetin ekonomik dhe profilin e transaksioneve të klientit;
- d) urdhër transferta fondesh ose depozita për vlera jo të mëdha që tërhiqen në formën e çeqeve dhe drafteve bankare ose dërgesave, gati menjëherë, të gjitha ose pjesa më e madhe e këtyre fondeve transferohen në qytete ose shtete të tjera në mënyra që nuk përputhen me aktivitetin ose historikun e klientit;
- e) urdhër transferta fondesh për vlera të mëdha të ardhurash mbliidhen nga palë të treta, të cilat nuk kanë asnjë lidhje të dukshme familjare, biznesi ose profesionale me përfituesin në urdhër pagesë;
- f) një llogari klienti tregon sistematikisht lëvizje kreditimi dhe debitimi, të cilat nuk kanë lidhje të dukshme me transaksione të ligjshme, për mallra ose shërbime;
- g) fondet dërgohen ose priten (merren) nga i njëjti person drejt dhe nga llogari të ndryshme pa asnjë qëllim të dukshëm ekonomik;
- h) transferta fondesh të njëpasnjëshme, pas asnjë qëllim të dukshëm, të cilat mund të nënkuptojnë një përpjekje për të ndaluar gjurmimin e pronarëve përfitues;
- i) transferta fondesh jo të zakonshme midis llogarive të zotëruara në emër të personave juridikë nën të njëjtën pronësi (për shembull korporatat *off-shore* që i përkasin një pronari përfitues);
- j) transferta fondesh të përsëritura drejt një përfituesi, i cili është vendosur jashtë vendit dhe nuk zotëron një llogari në një bankë pritëse të huaj;

- k) transferta fondesh nga jashtë vendit drejt një klienti në Shqipëri, i cili vazhdimisht i transferon fondet tek një palë e tretë;
- l) transferta fondesh të vazhdueshme në vlera të ulëta drejt një klienti, i cili në vazhdimësi jep udhëzime për kryerje transfertash;
- m) fondeve dërgohen nga një bankë në tjetrën dhe përfundimisht kthehen në bankën dërguese;
- n) aktivitet i madh i transfertave të fondeve drejt dhe nga shtete të huaja nga një ndërmarrje e paangazhuar në tregtinë me jashtë;
- o) transferta të mëdha vlerash të ardhura nga jashtë vendit nga një person fizik ose juridik pa një arsye ekonomike të dukshme;
- p) një llogari korrespondente kreditohet me shuma të mëdha, të cilat janë jo tipike për këtë llogari.

6. Tregues të dyshimtë që lidhen me marrëdhëniet e biznesit:

- a) blerje ose shitje të mëdha me çmime jo proporcionale, në lidhje me vlerën aktuale të tregut ose vlerën e llogaritur (për shembull pasuri të patundshme dhe tituj, punime arti, bizhuteri, ar, mallra të tjera lukuksi, kompani, kontrata, patenta, aksione, licenca ose autorizime për aktivitete tregtare);
- b) ndërprerje e menjëhershme e marrëdhënieve kontraktore (veçanërisht nëse ndodh menjëherë pasi është vendosur), e shoqëruar me urdhra për likuidimin e shumave të mëdha në *cash* ose tranferta në favor të palëve të treta jashtë vendit;
- c) mbajtja e llogarive të ndryshme nga i njëjti klient në të njëjtin institucion financiar, veçanërisht nëse mbahen në degë të cilat janë të vendosura në zona afër njëra tjetrës, ose prokura të shumta për të kryer veprime në të njëjtin institucion financiar nga i njëjti klient;
- d) marrëdhënie të vendosura për të kryer transaksione brenda një kohe të shkurtër të cilat më pas përfundohen;
- e) marrëdhënie në emër të individëve ose firmave të cilat kryejnë veprime modeste, ndaj të cilave depozitohen shuma të mëdha të përsëritura, ose kredi nga palë të treta dhe që pasohen me urdhëra pagesash për afërsisht të njëjtat shuma dhe veçanërisht nëse transferohen jashtë;
- f) marrja e garancive, veçanërisht nga jashtë, për shuma të konsiderueshme nga palë të treta të panjohura për të cilët klienti nuk jep informacion të mjaftueshëm;
- g) nënshkrimi i marrëveshjeve kontraktuale me kufizime apo lënia si garanci e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme për palë të treta, të cilët duken se nuk kanë lidhje me klientin;

- h) paraqitja e përsëritur e garancive nga palë, të cilët nuk janë palë fillestare kontraktuale;
- i) kërkesa që lidhen me llogari apo marrëdhënie të kualifikuara si të fjetura në përputhje me ligjet aktuale të paraqitura nga palë të treta, të cilët nuk janë të lidhur me pronarin origjinal të llogarisë;
- j) përdorimi i shpeshtë i kasave ose shërbimeve të ujdëstarisë/mirëmbajtjes ose depozita të shpeshta dhe tërheqje të pakove të vulosura, veçanërisht nëse bëhen në emër të një personi tjetër ose duke përdorur procedura që sugjerojnë veprimet që janë kryer për një palë të tretë;
- k) ndërhyrje të papritura nga palë të treta jashtë marrëdhënies së biznesit, me qëllim shlyerjen e detyrimit ose mbulimin e ekspozimit të klientit ndaj kredisë;
- l) dhënia e prokurës për akses ndaj kasafortave për personat e tretë që nuk kanë lidhje me klientin për të justifikuar një gjë të tillë.

7. Tregues të dyshimtë që lidhen me mënyrat dhe procedurat e pagesave:

- a) përdorim i përsëritur dhe i pajustificuar i *cash*-it, veçanërisht në shuma të mëdha dhe prerje të mëdha;
- b) depozitme në *cash* të cilat nuk shpjegohen nga aktiviteti ekonomik i klientit, veçanërisht kur përfshijnë para të vjetruara apo prerje të mëdha;
- c) tërheqja e shumave të mëdha në *cash*, përveç rasteve kur klienti specifikon nevojë të veçantë për këtë qëllim;
- d) këmbim i parave, sidomos për shuma të mëdha, duke përdorur para të vendeve të ndryshme të shumave të mëdha, veçanërisht nëse klienti kërkon prerje të mëdha ose llogaria nuk është e mjaftueshme për transaksionin;
- e) kërkesa për informacion mbi procedurat për konvertimin në euro/dollar apo monedha të tjera, veçanërisht nëse veprimi përsëritet ose përbën shuma të mëdha;
- f) depozita *cash* të shoqëruara me kërkesa të shpeshta, ose për shuma të mëdha, për instrumente mbajtëse, si çeket e udhëtarëve etj.;
- g) pagesa të konsiderueshme në *cash* për karta krediti, veçanërisht nëse klienti ka kryer tërheqje të shpeshta ose në shuma të mëdha;
- h) depozita të shpeshta *cash* të shoqëruara me tërheqje në ATM apo POS-e, veçanërisht nëse kryhen në të njëjtën ditë;
- i) përdorimi i transaksioneve të ndara për të shmangur kërkesat e identifikimit dhe regjistrimit, në mungesë të justifikimeve të dhëna nga klienti, me qëllim fshehjen me transaksione të tjera;

- j) transaksione të shpeshta për shuma pak më të ulëta se kufijtë e lejuar për raportim, veçanërisht që lidhen me *cash-in* ose që kryhen në degë të ndryshme;
- k) depozitime të shpeshta çeqesh në vlera pak më të ulëta se kufijtë e lejuar, sidomos nëse janë nënshkruar nga disa palë të treta;
- l) tërheqje për shuma të mëdha të urdhëruara nga çeqe të shumta, secila për shuma në vlerë pak më të ulët se ajo e lejuar;
- m) kërkesa të shpeshta për çeqe të cilat nuk përmbajnë klauzolën “e pa transferueshme”, veçanërisht nëse përdoren për *cash* thyhen jashtë vendit;
- n) përdorimi i instrumenteve të pagesave (kartave të debitit, të kreditit, të kartave të parapaguara, të parasë elektronike, në forma fizike dhe virtuale) procedurat e të cilave, përsëritja ose rëndësia ekonomike nuk përputhet me aktivitetin financiar të klientëve ose me biznesin e distributorëve apo të tregtarëve;
- o) përdorimin e shpeshtë të instrumenteve të pagesave të cilat lidhen me anomali në vëllime të shitjes nga një tregtar i caktuar, sidomos nëse procedura dhe shuma sugjeron anomali në dhënien e *cash* ndaj klientit;
- p) kërkesa për marrjen e instrumenteve të pagesës që janë të tepruara në shuma dhe frekuencë, ose kërkesa për rimbursime të shumave të papaguara nga një distributor i vetëm;
- q) kërkesa për rimbursime të shpeshta ose në shuma të mëdha ose pagesa për llogari të instrumenteve të pagesës së klientit;
- r) kërkesa për transferim të pagesave, nëpërmjet instrumenteve të pagesave për palë të treta të cilat duket se nuk kanë lidhje me klientin;
- s) kredi të shpeshta për instrumentet e pagesave të cilat shoqërohen nga tërheqje të menjëhershme të shumave të kredituara ose ndryshimi i menjëhershëm i procedurave të klientit për përdorimin e instrumentit;
- t) përdorimi i herëpashershëm i shumave të mëdha të parave, i shërbimeve të pagesave për qëllime të mbledhjeve apo transferimit të parave, në rastet kur vërehet se transaksionet nuk përputhen me gjendjen ekonomike të klientit dhe nuk janë të justifikuar plotësisht;
- u) transferta apo marrje të përsëritura të shumave të konsiderueshme të parave nga një klient në një kohë të shkurtër;
- v) transferta apo marrje të përsëritura të shumave të konsiderueshme të parave nga ose në favor të kundërpartive të ndryshme jashtë vendit, sidomos nëse këto vende nuk janë vendi i origjinës të klientit;
- w) transferta apo marrje parash nga ose në favor të kundërpartive në zona jo larg njëra tjetrës;

- x) transferta të përsëritura parash në nisje apo në mbërritje në drejtim dhe nga në zona të ndryshme;
- y) transferta apo marrje të përsëritura parash nëpërmjet një ose më shumë agjentëve financiarë në zona të ndryshme nga rezidenca apo vendi i lindjes;
- z) tranferta apo marrje të përsëritura parash nga agjentë financiarë në emrin e tyre ose të personave të lidhur (për shembull. të afërm ose bashkëjetues);
- aa) tranferta të përsëritura parash për shuma pak më të ulëta se kufiri i raportuar në favor të një përfituesi të urdhëruar nga persona të ndryshëm, veçanërisht nëse kryhet në një kohë të shkurtër, nëpërmjet procedurave që tregojnë ndarjen e këtyre shumave ose caktimin e përfaqësuesve;
- bb) depozita të përsëritura, veçanërisht depozita *cash*, të cilat justifikohen si të ardhura nga kumari, donacione ose trashëgimi;
- cc) parapagesa, përfshirë ato nga qiraja financiare, të cilat janë dukshëm më të mëdha se ato që kërkohen zakonisht;
- dd) shuma të mëdha fondesh të ardhura, veçanërisht nga jashtë, nëpërmjet llogarive që përdoren pak dhe që shoqërohen me tërheqje të mëdha ose transferta nëpërmjet procedurave apo drejt destinacioneve ose përfituesve që nuk lidhen me aktivitetin e klientit;
- ee) pagesa të përsëritura për shuma të mëdha të akumuluar, duke përfshirë përdorimin e çekut, në favor të personave juridikë ose individë të cilët nuk duket se kanë ndonjë marrëdhënie me mbajtësin e marrëdhënies;
- ff) blerja apo shitja e shumave të mëdha të monedhave, arit ose metaleve të tjera të çmuara ose të vlerave të tjera, veprime të cilat përsëriten.

8. Aktivitete të papajtueshme me aktivitetin e biznesit të klientit dhe profilin e përgjithshëm ekonomik të transaksioneve:

- a) një rritje e konsiderueshme e depozitave të një sipërmarrje, e pajustificuar nga një rritje përkatëse në aktivitetin e saj;
- b) shuma të mëdha parash (*cash*) janë depozituar në një llogari, pa justifikuar profilin ekonomik të transaksioneve të klientit;
- c) transaksionet e një firme tregtare kryhen zakonisht në *cash* më shpesh se në tituj dhe në instrumente të tjera pagesash, të cilat zakonisht përdoren për transaksionet tregtare;
- d) një llogari bankare e mbajtur nga një person fizik apo juridik është debituar apo kredituar me shuma të mëdha, të cilat nuk justifikojnë profilin ekonomik të transaksioneve të klientit;

- e) një numër i madh çeqesh ose urdhër pagesash janë depozituar në një llogari ose tërhequr *cash* prej saj, edhe pse një aktivitet i tillë nuk është i justifikuar nga natyra e aktivitetit të biznesit të mbajtësit të llogarisë;
- f) çeqet në shuma të konsiderueshme janë depozituar në një llogari pa ekzistuar një lidhje e dukshme familjare apo biznesi midis mbajtësit të llogarisë dhe xhiruesit të saj;
- g) një sipërmarrje depoziton *cash* në shuma që janë më të larta në krahasim me sipërmarrjet e një madhësie të ngjashme në të njëjtin sektor;
- h) përdorim të gjerë të lehtësirave të kreditimit dhe llojeve të tjera të tregut financiar, duke çuar në flukse të mëdha të kapitalit ndërmjet vendeve për të cilat nuk janë të zakonshme transaksione të tilla tregtare, duke marrë parasysh aktivitetin normal të biznesit të klientit;
- i) shuma të mëdha janë akumuluar në llogari depozitash dhe janë transferuar më pas në llogaritë jashtë vendit, transaksione komplekse të pajustificuar nga aktiviteti i biznesit të klientit;
- j) një klient aplikon për shërbime të administrimit të aseteve të tij në monedhë të huaj ose të titujve dhe burimi i fondeve është i panjohur ose në kundërshtim me gjendjen financiare dhe veprimtarinë e biznesit;
- k) depozita *cash* të konsiderueshme (në numër dhe në vlerë) nga persona fizikë ose juridikë pa asnjë qëllim të dukshëm ekonomik, sidomos nëse brenda një afati të shkurtër kohor shumat e depozituara janë transferuar nga llogaria e klientit në një destinacion që nuk duket të ketë lidhje me aktivitetin e tij;
- l) pronarë të anijeve ose kompanitë e transportit të mallrave angazhohen në transaksione ose veprimtari, të cilat nuk kanë lidhje me aktivitete transporti;
- m) transaksionet në lidhje me blerje në vlera të mëdha për llogari të të miturve, të personave me aftësi të kufizuar ose personave me kapacitet të kufizuar ekonomik ose ligjor për të kryer blerje të tilla;
- n) subjekte jo-fitimprurëse kryejnë transaksione të cilat nuk janë tipike për qëllimin ose aktivitetin normal të tyre;
- o) transaksionet e kryera midis palëve që nuk veprojnë në emër të tyre por bëjnë përpjekje për të fshehur identitetin e përfituesit të vërtetë.

9. Transaksione ose sjellje të tjera të dyshimta të klientit:

- a) ndryshime të shpeshta dhe të pashpjegueshme në numrat e telefonit fiks apo celular, si dhe adresa jo aktive të e-mailit të kompanisë;
- b) sjellje anormale nervoziteti nga klienti gjatë kryerjes së transaksionit;
- c) llogari të mbyllura brenda n një kohe të shkurtër nga hapja e tyre, në veçanti pasi banka kërkon dorëzimin e dokumenteve të nevojshme, si dhe në rast kur fondet përkatëse janë transferuar;

- d) një rritje e konsiderueshme në dërgesat e parave *cash* për/nga një ose disa degë të caktuara bankare të një rajoni të caktuar;
- e) transaksionet që përfshijnë persona juridikë të krijuar kohët e fundit, kur shuma është e madhe në krahasim me aktivitetin e tyre;
- f) transaksionet që përfshijnë persona juridikë që kanë ndërprerë veprimtarinë ose përballen me vështirësi financiare;
- g) një person fizik ose juridik që vendos të mbyllë llogaritë e tij si rezultat i publicitetit negativ;
- h) ekzistojnë zëra në komunitetin lokal që klienti mund të jetë përfshirë në veprimtari të paligjshme;
- i) një klient evidenton fitime tepër të larta nga lojërat e fatit ose bastet;
- j) klientët mbajnë llogari pranë disa bankave që operojnë në të njëjtin rajon, pa një qëllim të dukshëm ekonomik;
- k) klienti këmbëngul në kryerjen e veprimeve vetëm nëpërmjet një punonjësi specifik të bankës, madje edhe për transaksione rutinë, apo pezullon/ndërpret kryerjen e tyre gjatë mungesës së këtij punonjësi ;
- l) transferta të shpeshta të fondeve në një llogari të mbajtur nga një individ me të ardhura të ulëta;
- m) çeqet në emër të bartësit janë lëshuar dhe arkëtohen pasi janë nënshkruar disa herë;
- n) një llogari bankare është kredituar vazhdimisht me anë të çeqeve të “udhëtimit” në valutë të huaj;
- o) titujt janë blerë ose shitur në mënyrë të përsëritur pa asnjë dallim të dukshëm ekonomik (për shembull me humbje për investitorin).

10. Transaksionet e organizatave jo-fitimprurëse ose bamirëse:

- a) burimet e fondeve nuk janë në përputhje me madhësinë e fondeve të mbledhura, për shembull shuma të mëdha mbledhen nga komunitete, anëtarët e të cilëve kanë standard të ulët jetese;
- b) një rritje e papritur në frekuencën dhe madhësinë e transaksioneve ose e kundërta, për shembull fondet qëndrojnë në llogarinë e organizatës për një kohë të gjatë;
- c) donacionet burojnë ekskluzivisht nga jo-rezidentët e vendit ku organizata është regjistruar;

- d) transfertat e fondeve në vende të ndryshme, veçanërisht në vendet me rrezikshmëri të lartë, kur kjo nuk justifikohet nga qëllimi i organizatës ashtu siç është specifikuar në statutin e saj;
- e) organizatat pa staf, zyra, numra telefoni etj..

11. Përdorimi i kasave të sigurisë (*safe-deposit box*):

- a) përdorimi i shpeshtë i lehtësirave për ruajtjen e depozitave nga qiramarrësit e përbashkët ose përfaqësuesit e tyre, sidomos kur përfshijnë pako masive, të cilat mund të përdoren për të transportuar shuma të mëdha parash (*cash*) ose objekte të tjera;
- b) vizita gjithnjë e më të shpeshta për në kasat e sigurisë (*safe-deposit box*) të një dege të caktuar banke, në veçanti nga individë të cilët nuk punojnë ose jetojnë në zonën pranë asaj dege, pavarësisht se shërbime të ngjashme ofrohen nga një degë që ndodhet më afër shtëpisë ose biznesit të tyre;
- c) ndryshime të shpeshta të qiramarrësve të përbashkët të kasave të sigurisë (*safe-deposit box*).

12. Kreditë:

- a) shlyerje e plotë ose e pjesshme e ktredisë së marrë nga kredimarrësi, në rast kur origjina e fondeve është e panjohur;
- b) garancia për një kredi sigurohet nga një garantues i panjohur për bankën (institucionin financiar) dhe që nuk ka lidhje të dukshme me kredimarrësin;
- c) një klient kërkon të marrë kredi pa ndonjë qëllim të deklaruar dhe është i gatshëm të ofrojë *cash* për garanci;
- d) aplikimi për një kredi mbështetur në asete, të cilat kanë origjinë të paqartë ose nuk përputhen me pozicionin financiar të aplikuesit;
- e) një klient kërkon të përfitojë kredi, në rast kur origjina e pjesëmarrjes së tij është e panjohur ose e pashpjegueshme;
- f) një klient merr një kredi dhe nuk e përdor atë, por e depoziton shumën në një llogari për një farë kohe dhe më pas kryen tërheqjen *cash* të kësaj shume;
- g) klienti siguron asete lehtësisht të likuidueshme si kolateral për një kredi për të blerë ose ristrukturuar një pronë;
- h) klienti transferon fonde jashtë vendit në mënyrë që të përdoren si kolateral për një kredi dhe pastaj transferon shumën në vendin e tij (kthen fondet mbrapsht), duke e paraqitur atë si një kredi të dhënë për atë ose biznesin e tij;
- i) kërkesa për kredi të mëdha të mbështetura nga kolaterali ose garanci personale nga persona me zyra të regjistruara në vende apo territore me rrezik të lartë ose me kolaterale të vendosur në këto vende;

- j) kërkesa të herë pas hershme për kredi të bëra nga një person i vetëm ose persona të lidhur, të cilët lenë peng si kolateral mallra të papërcaktuara në origjinë;
- k) regjistrimi në besim (*fiduciary*) i aseteve ose instrumenteve financiare që ndiqen menjëherë nga transferimi i tyre tek të tretë ose prapa tek krijuesi i *trustit*;
- l) pagesa të përsëritura jashtë vendit nga firma që pretendohet se kryejnë biznes ndërkombëtar, por që nuk kryejnë lëvizje fondesh në lidhje me transaksionet monetare;
- m) kredi për tregëti ndërkombëtare, në letër kreditë e të cilave nuk përputhen shuma ose lloj i shërbimeve dhe mallrave me ato të cilat këta klientë kryejnë/prodhojnë, veçanërisht kur nuk ka lidhje midis këtyre shërbimeve dhe vendit të specifikuar në letër kredi;
- n) cedimi i kredive, veçanërisht brenda një grupi, në mungesë të ndonjë marrëdhënieje tregtare apo financiare, bazuar në marrëdhënie që nuk janë konsistente me biznesin apo me personat e përfshirë;
- a) paraqitja e titujve/letrave me vlerë për shuma të konsiderueshme, veçanërisht nëse nuk janë gjerësisht të përdorura , të shoqëruara me kërkesën për t'u likuiduar në *cash* ose si depozitë kolaterali për një kredi.

13. Sjellje e dyshimtë e punonjësve:

- a) një punonjës që bën jetesë luksoze e cila nuk justifikohet me të ardhurat e tij;
- b) një punonjës nuk zbaton (me dashje) politikat dhe procedurat e vendosura nga institucioni financiar, në veçanti kur ai është angazhuar në administrimin e aseteve për klientë të rëndësishëm;
- c) një punonjës nuk preferon të marrë leje për pushime;
- d) një punonjës bisedon/krijon afrimet me klientët më shumë se zakonisht.

14. Tregtia e mallrave:

- a) Mbifaturimi apo nënfaturimi i mallrave ose shërbimeve, duke përdorur teknika të ndryshme;
- b) faturime të shumta të mallrave dhe shërbimeve;
- c) mospërputhje të konsiderueshme midis përshkrimit të artikullit në faturën e transportit dhe faturës;
- d) madhësia e dërgesës duket në kundërshtim me shkallën e aktivitetit normal të biznesit të eksportuesit ose importuesit;

- e) lloji i mallit që po transportohet mund të jetë me vlerë të madhe dhe vëllim të vogël (për shembull stoli të çmuara) të cilat kanë shkallë të lartë qarkullimi dhe paraqesin vështirësi vlerësimi;
- f) lloji i mallit që po transportohet duket i papajtueshëm me aktivitetin normal të biznesit të eksportuesit ose importuesit;
- g) malli është dërguar për në ose prej një vendi me jurisdikcion të përcaktuar si “me rrezik të lartë” për aktivitetet e pastrimit të parave;
- h) mënyra e pagesës duket e papajtueshme me karakteristikat e rrezikut të transaksionit, për shembull parapagimi ndaj një furnitori të ri që ndodhet në një vend me “rrezik të lartë”.

15. Sektori i pasurive të patundshme:

- a) shitja e një prone kundrejt pagesës duke përdorur çeqe të nënshkruara në favor të njërit palë ose ndaj një pale të tretë që nuk ka lidhje me transaksionin e shitjes;
- b) shitja e një prone kundrejt pagesës në disa çeqe të lëshuara brenda një dite dhe në favor të një shitësi të vetëm (të pronës).
- c) shitja e një prone kundrejt pagesës me para në dorë (*cash*) me prejardhje nga llogaria e një pale të tretë e cila nuk ka asnjë lidhje me personin e përcaktuar si blerës në marrëveshjen e shitjes;
- d) shitja e një prone pa ndjekur formalitetet ligjore të detyrueshme;
- e) sipas marrëveshjes së shitjes, prona duket që është blerë nga shitësi kohët e fundit;
- f) transaksionet e pasurive të patundshme me një çmim shumë më të lartë ose shumë më të ulët se vlera reale e tregut.

16. Pastrimi i parave nëpërmjet metodave të reja të pagesave/produkteve elektronike:

- a) një klient kryen transaksione me vlerë të madhe duke përdorur një kartë të parapaguar, duke përfituar nga mundësia e mbushjes së kartës pa praninë fizike në bankë, për shembull nëpërmjet ATM-ve, internet banking etj.;
- b) një klient blen një numër të madh të kartave të parapaguara nga i njëjti institucion financiar;
- c) balanca të mëdha të kartave të debitit dhe kreditit shlyhen në *cash*, pa patur informacion për burimin e fondeve;
- d) një klient krediton llogarinë e tij me shuma të mëdha pothuajse ekskluzivisht nëpërmjet një ATM-je, ndoshta duke treguar qëllimin e tij për të shmangur shfaqjen personale në institucionin financiar.

17. Tregues të dyshimtë që lidhen me personat juridikë:

- a) llogaritë janë hapur pranë një banke nga disa korporata jashtë vendit, të cilat kanë të njëjtin pronar përfitues dhe flukse fondesh komplekse ose të pazakonta ndodhin ndërmjet llogarive të tilla;
- b) përpjekje për të fshehur identitetin e pronarit përfitues nëpërmjet strukturave komplekse të personave juridikë;
- c) një llogari e një personi juridik merr një transfertë krediti nga një tjetër person juridik dhe që janë në pronësi të të njëjtit përfitues, duke përdorur si dokument mbështetës një kontratë kredie, duke përcaktuar kushte dhe terma të pazakontë, për shembull kredi pa interes ose të pakolateralizuar/pasiguruar.

18. Tregues të dyshimtë të lidhur specifikisht me *leasing* dhe *factoring*:

- a) shlyerje e papritur dhe përfundim i marrëdhënies kontraktore sapo kontrata ka hyrë në fuqi sidomos për sa i takon *leasing*-ut të makinave;
- b) një shlyerje e papritur e detyrimeve të prapambetura për një periudhë të gjatë;
- c) një garanci është dhënë nga një person që nuk ka lidhje të dukshme biznesi apo personale të qiramarrësit / faktorit;
- d) klienti refuzon të ofrojë informacion shtesë për të dhënat e aktivitetit kur i kërkohet apo gjatë shqyrtimit të dosjes;
- e) kur një kompani *off-shore* kërkon të hyjë në një marrëdhënie *leasing*-u dhe subjekti ka dyshime për pronarin përfitues;
- f) subjekti përballet me një aplikim për krijimin e marrëdhënieve të biznesit me një çmim shumë më të lartë se mesatarja e tregut;
- g) detyrimet e klientit janë paguar me çeqe në shuma të mëdha, nga një palë e tretë miratuar në favor të klientit pa të dhëna për një lidhje familjare apo biznesi;
- h) raste kur klienti kryen mbifaturim ose nënfaturim.

a) Tabela e analizës sasiore të faktorëve të rrezikut

| Koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut ⁶⁶ | Faktorët e rrezikut | Analiza Sasiore |
|---|-----------------------------------|-----------------|
| 0.33 | Rreziku gjeografik | |
| 0.34 | Rreziku i klientit | |
| 0.33 | Rreziku i produkteve | |
| 1 | Rezultati: Analiza sasiore | |

b) Hapat e matjes së rrezikut⁶⁷

| Hapat e matjes së rrezikut | Analiza sasiore ⁶⁸ | Masat | Analiza cilësore | | Niveli I rrezikut |
|----------------------------|-------------------------------|-----------------------|------------------|-------------------------------------|-------------------|
| a | 0.5 | Vigjilencë e duhur | | | Niveli i moderuar |
| a + b | 0.665 | Vigjilencë e zgjeruar | Analizë cilesore | | Nivel i lartë |
| a+b+c | 0.835 | Vigjilencë e Zgjeruar | Analizë cilësore | Gjykim për raportim potencial | Nivel i lartë |
| C1 | 1 | Vigjilencë e Zgjeruar | Analizë cilësore | Vendimmarrje për raportim potencial | Raportim në DPPP |

⁶⁵ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.55, datë 28.08.2013.

⁶⁶ Kujdes, këta koeficientë janë konsideruar vetëm për ilustrim.

⁶⁷ Referoju pikës “V. Hapat e matjes së rrezikut.”

⁶⁸ Kujdes, këto rezultate kanë dalë në bazë të koeficientëve të ponderimit të faktorëve të rrezikut që janë përdorur në tabelën e matjes së rrezikut. Në çdo rast të përdorimit të koeficientëve të tjerë, institucioni duhet të ndërtojë një analizë në përputhje me kërkesat ligjore për kategorizimin e çështjes në vigjilencë të duhur, të thjeshtuar apo të zgjeruar.

c) Matrica e vlerësimit të kriterit

| Kriteri i rrezikut | Analiza sasore | | Analiza cilësore | | | | | | | |
|-----------------------|--------------------------------|--|---|---|---|--|-----------------------------------|------------------|--|--|
| | EDD=1 CDD=0.5 ⁶⁹ | Kategoritë e Faktorit | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | |
| | | | Qëllimi i hapjes së një llogarie ose të një marrëdhënieje biznesi | Niveli i aktiveve ose madhësia e transaksioneve | Niveli i rregullimit ose regjime të tjera të kontrollit ose të qeverisjes/drejtimi t ku klienti është subjekt | Kohëzgjatja e marrëdhënies e të biznesit | Përdorimi i mjeteve të ndërmjetme | Burimi i fondeve | Dokumentacioni justifikues për transaksionet | |
| Vigjilencë e zgjeruar | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | Kategori e përcaktuar nga institucioni | | | | | | | | |
| Vigjilencë e duhur | | Kategori e përcaktuar nga institucioni | | | | | | | | |
| | | Kategori e përcaktuar nga institucioni | | | | | | | | |
| | | Kategori e përcaktuar nga institucioni | | | | | | | | |

⁶⁹ Kujdes EDD=Vigjilencë Zgjeruar; CDD=Vigjilencë e Duhur dhe e Thjeshtuar; EDD do të marrë vlerën 1 ndërsa CDD vlerën 0.5.

d) Shembuj ilustrues për matricën⁷⁰

Rasti I.

Një klient rezident me profesion “doktor”, ka hapur llogari në bankën X. Llogaria ka 6 muaj që kreditohet çdo muaj me 2000 Euro nga kompania “Z”, ku klienti është i punësuar. Në vazhdim, me kërkesë të klientit, institucioni debiton gjysmën e fondeve duke ia dërguar ato familjes.

1. Analiza sasiore

| Koeficientët | Vlerësim i ekspozimit ndaj rrezikut | Analiza Sasiore |
|--------------|-------------------------------------|-----------------|
| 33% | Rreziku gjeografik | 0.5 |
| 34% | Rreziku i klientit | 0.5 |
| 33% | Rreziku i produkteve | 0.5 |
| 100% | Rezultati: | 0.5 |

Në bazë të tabelës “Analiza sasiore e kriterëve të rrezikut”, shikojmë që rezultati i analizës sasiore, bazuar në tabelën “Hapat e matjes së rrezikut”, tregon se institucioni financiar duhet të aplikojë masat e parashikuara në shkronjën “a” të tabelës.

Rasti II.

Ndodhemi në të njëjtat kushte si në rastin e parë por tashmë klienti është me shtetësi gjermane, paga 6000 Euro si dhe gjysma e fondeve shkojnë në Gjermani.

1. Analiza sasiore

| Peshat | Vlerësim i ekspozimit ndaj rrezikut | Analiza Sasiore |
|--------|-------------------------------------|-----------------|
| 33% | Rreziku gjeografik | 0.5 |
| 34% | Rreziku i klientit | 1 |
| 33% | Rreziku i produkteve | 0.5 |
| 100% | Rezultati: | 0.665 |

⁷⁰ Shembujt janë tërësisht hipotetik dhe janë vetëm për të ilustruar funksionimin e analizës sasiore. Në çdo rast institucionet financiare duhet të kryejnë një analizë shumë më cilësore se ajo e përmendur në udhëzim.

Në bazë të tabelës “Analiza sasiore e kriterëve të rrezikut”, shikojmë që rezultati i analizës sasiore, bazuar në tabelën “Hapat e matjes së rrezikut” tregon që institucioni financiar duhet të aplikojë masat e parashikuara në shkronjat (“a”+“b”), sepse klienti është jorezident. Si rrjedhim, analiza sasiore ka identifikuar rrezikun potencial që vjen nga jo-rezidentët. Në bazë të tabelës “Hapat e matjes së rrezikut”, institucioni duhet të aplikojë analizën cilësore.

Në bazë të tabelës “Matrica e vlerësimit të kriterit”, gjykojmë për të tre kriteret e rrezikut në përputhje me kategoritë dhe variablat e tyre.

| | | Analiza Cilësore | | | | | | | |
|-------------------------------|------------------|---|---|--|---|---|-----------------------------------|-------------------------|--|
| Analiza sasiore | | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | |
| Rreziku gjeografik | EDD=1 CDD=0.5 | Kategoritë që mund të rezultojnë në konstatimin se një vend paraqet një rrezik më të lartë përfshijnë | Qëllimi i hapjes së një llogarie ose të një marrëdhënieje biznesi | Niveli i aktiveve ose madhësia e transaksioneve | Niveli i rregullimit ose regjime të tjera të kontrollit ose të qeverisjes/drejtimt ku klienti është subjekt | Kohëzgjatja e marrëdhënieve të biznesit | Përdorimi i mjeteve të ndërmjetme | Burimi i fondeve | Dokumentacioni justifikues për transaksionet |
| | 0.5 | Nuk ekziston ndonjë listë e nxjerrë nga burime të besueshme informacioni që Gjermania mbart rrezik të lartë | | | | | | | |
| | 0.5 | Llogari page.. Janë kryer transferita. | | | | | | | |
| Rreziku I produkteve | | | | | | | | | |
| Rrezikun e klientit/entitetit | 1 | Jo rezident | Klientit i kreditohet llogaria nga paga. Gjysmën e fondeve e dërgon tek familja në Gjermani | Llogaria kreditohet vetëm nga kompania “Z” për 6000/Muaj | I lartë | 6 muaj | Jo | Punësimi në kompaninë Z | Të ardhurat nga paga |

Nga analiza cilësore, kuptojmë se treguesit e analizës sasiore kanë identifikuar një kategori (jo rezident), që në përputhje me kuadrin ligjor, institucioni e ka kanalizuar në vigjilencë të zgjeruar. Qëllimi i hapjes së llogarisë është kryer për kreditimin e pagës nga kompania “Z”. Lëvizja e fondeve kryhet në destinacion plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Niveli i aktivitetit është në përputhje me profilin e klientit si dhe burimin e fondeve. Kohëzgjatja e marrëdhënieve të biznesit është e shkurtër por aktiviteti i llogarisë paraqet një zhvillim normal të lëvizjeve në llogari. Analiza cilësore tregon për materialitet të ulët.

Rasti III:

Ndodhemi në të njëjtat kushte si në rastin e parë por tashmë klienti është më shtetësi gjermane, paga 10 000 Euro si dhe dyfishi i fondeve shkojnë në destinacione me rrezik gjeografik.

| Peshat | Vlerësim i ekspozimit ndaj rrezikut | Analiza Sasiore |
|--------|-------------------------------------|-----------------|
| 0,33 | Rreziku gjeografik | 1 |
| 0,34 | Rreziku i klientit | 1 |
| 0,33 | Rreziku i produkteve | 0.5 |
| 100% | Rezultati: | 0.835 |

Në bazë të tabelës “Analiza sasiore e kriterëve të rrezikut”, vërejmë që rezultati i analizës sasiore, bazuar në tabelën “Hapat e matjes së rrezikut” tregon që institucioni financiar duhet të aplikojë masat e parashikuara në shkronjat (“a”+“b”+“c”), sepse klienti është jorezident si dhe dërgon fonde në destinacion off-shore. Si rrjedhim, analiza sasiore ka identifikuar rrezikun potencial që vjen nga jo-rezidentët si dhe rrezikun që vjen nga destinacione gjeografike/juridiksione jo bashkëpunuese me standartet e FATF. Në bazë të tabelës “Hapat e matjes së rrezikut”, institucioni duhet të aplikojë analizën cilësore si dhe të gjykojë për një raportim të mundshëm.

| |
|--------------------------------------|
| Rreziku gjeografik |
| Rreziku i produkteve |
| Rrezikun e klientit/entitetit |

| Analiza sasiore | |
|------------------|---|
| EDD=1 CDD=0.5 | Kategoritë që mund të rezultojnë në konstatimin se një vend paraqet një rrezik më të lartë përfshijnë |
| 1 | Destinacioni përfshihet në listën e FATF si juridiksion jo bashkëpunues |
| 0.5 | <i>Llogari page. Janë kryer transferata.</i> |
| 1 | <i>Jo rezident</i> |

| Analiza Cilësore | | | | | | |
|---|--|---|---|-----------------------------------|--|--|
| Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat | Variablat |
| Qëllimi i hapjes së një llogarie ose të një marrëdhënieje biznesi | Niveli i aktiveve ose madhësia e transaksioneve | Niveli i rregullimit ose regjime të tjera të kontrollit ose të qeverisjes/drejtimi t ku klienti është subjekt | Kohëzgjatja e marrëdhënieve të biznesit | Përdorimi i mjeteve të ndërmjetme | Burimi i fondeve | Dokumentacioni justifikues për transaksionet |
| 1 | | Klienti dërgon fonde në Ekuador vend i cili gjykohet si jo bashkëpunues | | | | |
| | transferata mbart rrezik | | | | | |
| 1 | Llogaria kreditohet nga kompania "Z" për 10000/muaj Megjithatë është identifikuar se ka shumë kreditime cash | | 6 muaj | Jo | Punësimi në kompaninë Z për 10000 Euro. Ndërsa për pjesën tjetër mungon. | Kreditmi i llogarisë nga kompania "Z" dhe derdhje cash |

Nga analiza cilësore, kuptojmë se treguesit e analizës sasiore kanë identifikuar një kategori (jo rezident), si dhe një destinacion që në përputhje me kuadrin ligjor, institucioni e ka kanalizuar në vigjilencë të zgjeruar. Qëllimi i hapjes së llogarisë është kryer për kreditimin e pagës nga kompania "Z". Lëvizja e fondeve kryhet në destinacion/juridiksion jo bashkëpunues në përputhje me standardet ndërkombëtare. Niveli i aktivitetit nuk është në përputhje me profilin e klientit si dhe burimin e fondeve. Kohëzgjatja e marrëdhënieve të biznesit është e shkurtër. Aktiviteti i llogarisë paraqet një zhvillim jo normal të lëvizjeve në llogari krahasuar me kreditimin e justifikuar nga kompania "Z". Si rrjedhim, pas grumbullimit të informacionit dhe analizës cilësore dhe faktit se personi përgjegjës në degë konstaton se klienti premtun se do ta sjellë dokumentacion justifikues, por ende nuk e ka paraqitur atë, strukturat drejtuese gjykojnë ta raportojnë rastin në autoritetin përgjegjës.

Tabela 1. Kategorizimi i klientëve

| | Numri total i klientëve të subjektit | Gjendja (teprica) e llogarive të klientëve në fund të periudhës raportuese (në mijë lekë)** | Pesha (në %) e numrit të klientëve të çdo kategorie ndaj numrit total të klientëve | Pesha (në %) e gjendjes (tepricës) së llogarive për çdo kategori ndaj totalit të gjendjes (tepricës) së llogarive |
|--|--------------------------------------|---|--|---|
| Kategoritë sipas rrezikut | | | | |
| KATEGORIA ME RREZIK TË LARTË | | | | |
| Persona të ekspozuar politikisht (PEP) | | | | |
| Organizata jofitimprurëse (OJF) | | | | |
| Kompani jorezidente | | | | |
| Individë jorezidentë | | | | |
| Klientë <i>Offshore</i> | | | | |
| Të tjerë, nëse ka | | | | |
| KATEGORIA ME RREZIK TË MESËM | | | | |
| Sipas ndarjes së vetë subjektit | | | | |
| KATEGORIA ME RREZIK TË ULËT | | | | |
| Sipas ndarjes së vetë subjektit | | | | |
| TOTALI | | | | |

* Këto të dhëna dërgohen pranë Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë një herë në vit, në formë të printuar dhe në rrugë elektronike.

⁷¹ Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

Tabela 2. Kategorizimi i transfertave

| | Numri total i transfertave | Vlera e transfertave (në mijë lekë)** | Pesha (në %) e numrit të transfertave të çdo kategorie ndaj numrit total të transfertave | Pesha (në %) e vlerës së transfertave për çdo kategori ndaj vlerës totale të transfertave |
|---|----------------------------|---------------------------------------|--|---|
| Transfertat | | | | |
| (I) TRANSFERTA NË NISJE (I.I)+(I.II) | | | | |
| (I.I) Brenda vendit | | | | |
| - nga të cilat, transfertat që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë | | | | |
| (I.II) Jashtë vendit | | | | |
| - nga të cilat, transfertat që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë | | | | |
| (II) TRANSFERTA NË MBËRRITJE (II.I)+(II.II) | | | | |
| (II.I) Brenda vendit | | | | |
| - nga të cilat, transfertat që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë | | | | |
| (II.II) Jashtë vendit | | | | |
| - nga të cilat, transfertat që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë | | | | |
| TOTALI I TRANSFERTAVE (I)+(II) | | | | |

** Për transaksionet në valutë, konvertimi në monedhën vendase kryhet me kursin e këmbimit të ditës së fundit të periudhës raportuese, mbi bazën e të cilit përgatiten edhe pasqyrat financiare.

Tabela 3. Të dhëna shtesë

| Subjekti | Viti paraardhës | Viti raportues |
|---|-----------------|----------------|
| Numri i RAD të raportuara | | |
| Numri i rasteve të analizuara nga subjekti, me dyshime për pastrim të parave ose financim terrorizmi (jo RAD) | | |
| Numri i rasteve të sinjalizuara nga degët/agentët | | |
| Masat administrative (në vlerë) | | |

**PYETËSOR PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE (PPP)/
PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (PFT)**

PJESA 1: INFORMACION MBI SUBJEKTIN

| | |
|---|-------|
| Emri i subjektit | |
| Drejtori i përgjithshëm | |
| Personi përgjegjës për PPP/PFT | |
| Struktura përgjegjëse në degë/agjenci për PPP/PFT | |
| Adresa | |
| Tel/Faks: | |
| Web: | |
| Sa degë/agjenci ka subjekti? | _____ |

*** Këto të dhëna dërgohen pranë Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë një herë në vit, në formë të printuar dhe në rrugë elektronike.**

⁷² Shtuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 5.4.2017.

PJESA 2: NJIH KLIENTIN TËND (NKT) / KËRKESA PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE (PPP) / PËR PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (PFT)

2.1 Praktika dhe procedura të përgjithshme për parandalimin e pastrimit të parave

| | | |
|----|--|--|
| 1. | A jeni ju apo ndonjë punonjësi juaj aktualisht (ose gjatë periudhës raportuese) subjekt i ndonjë hetimi, akuze, dënimi apo padie civile lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (Përgjigjja mund të mbështetet në formularët e vetëdeklarimit të nënshkruar nga vetë punonjësit, si dhe në verifikimet që subjekti mund të kryejë për raste të veçanta ose për të gjitha rastet.) | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 2. | A i përmbush subjekti rekomandimet e FATF? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 3. | A ka subjekti degë në ndonjë nga vendet që konsiderohen “jo bashkëpunuese” nga FATF? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 4. | A miratohen nga Këshilli Drejtues i subjektit, politikat për PPP/PFT? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 5. | A ka subjekti procedura të shkruara, që dokumentojnë proceset për parandalimin, identifikimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 6. | Sa kontrole janë kryer gjatë periudhës së raportuar, për vlerësimin e politikave/procedurave për PPP/PFT nga: | - Autoritetet mbikëqyrëse ____ - Autoritetet përgjegjëse ____ - Kontrolli i brendshëm ____ |
| 7. | A ka subjekti politika/procedura që mbulojnë marrëdhëniet me Personat e Ekspozuar Politikisht, në përputhje me kërkesat ligjore/rregullative? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 8. | A ka subjekti procedura të ruajtjes së të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 9. | A kërkon subjekti që politikat dhe procedurat e PPP-së të zbatohen në të gjitha degët dhe filialet e tij, brenda dhe jashtë vendit? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

2.2 Vlerësimi i rrezikut

| | | |
|-----|--|---|
| 10. | A kryen subjekti një vlerësim të bazuar mbi rrezikun, të bazës së klientëve dhe të transaksioneve të kryera? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 11. | Nëse përgjigjja e pyetjes 11 është “Po”, përcaktoni rreziqet e identifikuara nga vlerësimi. | _____ |

2.3. ⁷³Njih klientin tënd, vigjilenca e thjeshtuar, e duhur dhe vigjilenca e zgjeruar

| | | |
|-----|--|---|
| 12. | A ka subjekti politika që ndalojnë hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive anonime (d.m.th. llogari të identifikuar me numra, për të cilat subjekti nuk e di kush është pronari)? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 13. | A ka subjekti sisteme për identifikimin e klientëve të tij, në rastin e hapjes së llogarive/vendosjes së marrëdhënieve të biznesit (që përfshijnë për shembull: emrin, shtetësinë, adresën, numrin e telefonit, datëlindjen, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit dhe shtetin që e ka lëshuar atë)? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 14. | A ka subjekti kërkesa për mbledhjen e informacionit lidhur me aktivitetet e biznesit të klientëve të tij? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 15. | A mbledh subjekti informacione dhe a vlerëson politikat e procedurat e PPP/PFT të klientëve të tij, të institucioneve financiare dhe të marrëdhënieve ndërbankare? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

2.4 Transaksionet e raportueshme dhe identifikimi e parandalimi i transaksioneve me fonde të siguruar në mënyrë të paligjshme

| | | |
|-----|---|---|
| 16. | A ka subjekti procedura për identifikimin dhe raportimin e transaksioneve, të cilat duhet të raportohen tek autoritetet? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 17. | A ka subjekti politika/procedura, infrastrukturën e duhur apo kontrole për parandalimin ose identifikimin e transaksioneve të strukturuar? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 18. | A i monitoron subjekti transaksionet për klientët ose transaksionet që vlerëson se janë me rrezik të lartë (ku mund të përfshihen persona, subjekte apo shtete të përfshira në listat e shpërndara nga qeveria apo organizma ndërkombëtare), për të cilat nevojitet një vëmendje e veçantë ndaj këtyre klientëve apo transaksioneve para kryerjes së çdonjërit nga këto transaksione? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 19. | A e kontrollon subjekti bazën e të dhënave të klientëve përkundrejt listave të përditësuara të individëve/subjekteve, për t'u siguruar që nuk i ofron shërbime financiare ose nuk kryen transaksione biznesi me këta individë/subjekte, me qëllim identifikimin e aktiviteteve jo të zakonshme? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

⁷³ Ndryshuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 18.12.2019.

| | | |
|-----|---|---|
| 20. | Si bëhet kontrolli i bazës së të dhënave? | - Në mënyrë manuale <input type="checkbox"/> - Në mënyrë automatike <input type="checkbox"/> |
| 21. | A ka subjekti politika që sigurojnë në mënyrë të arsyeshme që ai nuk do të kryejë transaksione me apo në emër të bankave guaskë, nëpërmjet ndonjë llogarie apo produkteve të tij? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 22. | A ka subjekti politika që vlerësojnë bankat korrespondente në lidhje me standardet e PPP/PFT? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 23. | A ka subjekti marrëdhënie biznesi me politikanë ose figura zyrtarësh të lartë, ose me anëtarët e ndonjë regjimi që ka gjasa të jenë të përfshirë në korrupsion ose aktivitete të tjera të paligjshme? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

2.5 Monitorimi

| | | |
|-----|--|---|
| 24. | A ka subjekti procedura për monitorimin e aktiviteteve të dyshimta ose të pazakonta, që mbulojnë transferime fondesh ose instrumente monetare (siç janë: çeqe udhëtari, transfertat parash, etj.)? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 25. | A është zbatimi i politikave dhe procedurave të PPP / PFT / NKT i monitoruar në mënyrë të vazhdueshme? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

2.6 Trajnimi për PPP

| | | |
|-----|--|---|
| 26. | A u ofron subjekti trajnime për PPP/PFT punonjësve përkatës, që përfshijnë identifikimin dhe raportimin e transaksioneve që duhet të raportohen te autoritetet përgjegjëse, shembuj të formave të ndryshme të pastrimit të parave duke përfshirë edhe produktet dhe shërbimet e ofruara prej tij, si dhe politikat e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 27. | A i ruan subjekti të dhënat e seancave të trajnimit, duke përfshirë të dhënat e pjesëmarrjes dhe materialet e përdorura gjatë trajnimit? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 28. | A ka subjekti politika për komunikimin me punonjësit përkatës për ndryshimet ligjore/rregullative që lidhen me PPP/PFT? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 29. | A ka subjekti agjentë për të kryer disa nga funksionet e tij? Nëse po, a i ofron këtyre agjentëve trajnime për PPP, që përfshijnë identifikimin dhe raportimin e | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

| | | |
|-----|--|---|
| | transaksioneve që duhet të raportohen te autoritetet përgjegjëse, shembuj të formave të ndryshme të pastrimit të parave duke përfshirë edhe produktet dhe shërbimet e ofruara prej tij, si dhe politikat e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| 30. | A ka kryer subjekti kontrolle të agjentëve për zbatimin e detyrimeve ligjore/rregullative për PPP/PFT? | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |

Dokumente që i duhen bashkëngjitur përgjigjes suaj:

1. Kopje të politikave/procedurave të subjektit në lidhje me PPP/PFT;
2. Kopje e vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të kryer nga subjekti;
3. Informacion përmbledhës mbi gjetjet, rekomandimet dhe masat e marra nga kontrolli i brendshëm për çështjet e PPP/PFT, gjatë periudhës së raportuar;
4. Informacion përmbledhës për trajnimet e kryera për strukturën përgjegjëse dhe punonjësit e përfshirë në procesin e PPP/PFT.

Unë konfirmoj që informacioni i mësipërm është i përditësuar, i saktë dhe pasqyron politikat: Njih Klientin Tënd / Parandalimit të Pastrimit të Parave / Parandalimit të Financimit të Terrorizmit të subjektit që përfaqësoj.

| | |
|-------------------|---------------------------|
| Emri: | Numri i telefonit: |
| Pozicioni: | E-mail: |
| Data: | Nënshkrimi: |